



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 9/2024 regjistër (JR)
Datë 12.03.2024

Nr. 41 i vendimit
Datë 19.05.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më 19.05.2025, ditën e hënë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muça, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Shkodër.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 721, datë 06.12.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 179/b, paragrafi 5; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

analizoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex-officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka zhvilluar hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, përkatësisht për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Në zbatim të përcaktimeve të neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016, nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar¹ (në vijim “AKSIK”), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), sipas neneve 40 - 44 të po këtij ligji.

2.1. ILDKPKI-ja, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për pasurisë, i ka dërguar Komisionit raport-kontrollin², ku konkludohet se: *Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton për subjektin e rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani, sa vijon:*

- *deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje pasurie;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2. AKSIK-u ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport³ për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, grupi i punës ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

2.3. KLP-ja, për subjektin e rivlerësimit, ka hartuar raportin⁴ për analizimin e aftësive profesionale, të cilin ia ka përcjellë Komisionit.

¹ *Ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).*

² *Me nr. {***} prot., datë 28.02.2018.*

³ *Me shkresën nr. {***} prot., datë 04.10.2023, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 05.10.2023, të KDZh- së.*

⁴ *Me nr. {***} prot., datë 27.06.2022.*

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 721, datë 06.12.2023, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.*
4. Vendimmarrja e Komisionit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani, është bazuar në përfundimet e arritura në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, të cilat kanë passjellë aplikimin e nenit 61, pikat 3 dhe pika 5 të ligjit nr. 84/2016 dhe dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, duke konkluduar si vijon.

4.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

Lidhur me pasuritë apartament me sip. 74 m² dhe sip. 47 m², subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë bashkëpronësinë me 1/3 pjesë nga trashëgimia ligjore e babait të saj, duke u përpjekur të fshehë nga kontrolli apo verifikimi marrëdhënien e plotë të pronësisë mbi këto pasuri e, për pasojë, edhe burimet e krijimit të tyre, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. [...]

Lidhur me depozitimet e kryera në llogarinë dyemërore në BKT, subjekti i rivlerësimit dhe babai i saj kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 2.600.000 lekë, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. [...]

Lidhur me pasuritë, dy apartamente banimi në vlerën 113.000 euro, në Shkodër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë në deklaratën “vetting” 2017 bashkëpronësinë me 1/3 pjesë nga trashëgimia ligjore e babait të saj, duke u përpjekur të fshehë nga kontrolli apo verifikimi marrëdhënien e plotë të pronësisë mbi këto pasuri e, për pasojë, edhe burimet e krijimit të tyre, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. [...]

Lidhur me huanë nga mbesa, në shumën 2.600 euro, në vitin 2004, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shumën 2.600 euro në vitin 2004, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga shkronja “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. [...]

Lidhur me depozitimin “cash” të shumës 990.000 lekë nga nëna e subjektit G. L., krijohen dyshime të arsyeshme se kjo shumë është pasuri e subjektit të rivlerësimit, duke u përpjekur të fshehë nga kontrolli dhe verifikimi burimet e krijimit të saj, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësim të pasurisë dhe gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

4.2. Për kriterin e kontrollit të figurës:

Bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni vlerëson se: (a) subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; (b) nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (c) nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës.

4.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

Në përfundim të rivlerësimit të aftësive profesionale, duke çmuar se: (i) në periudhën e rivlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, subjektit të rivlerësimit i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” nga

*Prokurori i Përgjithshëm dhe rrethanat që kanë shërbyer si shkak për dhënien e saj; (ii) dyshimet e arsyeshme të krijuara nga shqyrtimi i procedimit penal nr. {***} të vitit 2020, lidhur me moskryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore dhe interpretimit të gabuar të ligjit me pasoja të rënda të interesave shtetërorë; (iii) faktin që subjekti i rivlerësimit, në ndjekjen e procedimit penal nr. {***} të vitit 2022, ka vepruar në kushtet e papajtueshmërisë, duke cenuar parimin kushtetues të paanësisë – Komisioni, në përputhje me interpretimin pajtues të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, në vlerësimin tërësor të fakteve dhe rrethanave që përmbajnë këto praktika, vlerëson se shkeljet e konstatuara nuk përshihen në kategorinë e atyre që plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, por janë shkelje që kanë cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë e, për pasojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në pikën 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

4.4. Për vlerësimin tërësor:

*Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut tek organet e drejtësisë, pasi, në ndjekjen e procedimit penal nr. {***} të vitit 2022, ka vepruar në kundërshtim me parimin e paanësisë, parashikuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës.*

III. Ankimi kundër vendimit të Komisionit

5. Kundër vendimit të Komisionit nr. 721, datë 06.12.2023, ka paraqitur ankim subjekti i rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani, nëpërmjet të cilit ka ngritur pretendime me të cilat kundërshton konkluzionet e Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe për vlerësimin e aftësive profesionale, duke kërkuar nga trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “trupi gjykues”), ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e saj në detyrë.

A. Shkaqe ankimi që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

6. Subjekti i rivlerësimit, në tërësi, kundërshton metodologjinë e analizës financiare të kryer nga Komisioni, duke pretenduar se ajo nuk është e drejtë dhe e saktë dhe, si e tillë, nuk pasqyron situatën faktike, pasi nuk ka konsideruar se: **(i)** ndarja, pas vdekjes së babait të saj, me trashëgimi ligjore, e pasurisë së krijuar prej tij, përmes së cilës subjekti ka përfituar 1/3 e pasurisë së tij, është bërë nga noteri dhe se subjekti nuk është përpjekur të fshehë nga kontrolli marrëdhënien e pronësisë që ajo ka mbi apartamentet; **(ii)** analiza financiare e bërë për vëllain e subjektit, është e padrejtë dhe e pabazuar ligjërisht, pasi ai nuk është person i lidhur apo tjetër i lidhur me subjektin; **(iii)** në analizën financiare të kryer nga Komisioni, nuk është konsideruar se nga viti 1992 e deri në vitin 1995, vëllai i subjektit me bashkëshorten kanë punuar në emigracion, Itali, pa dokumente; **(iv)** në analizën financiare të Komisionit, nuk është mbajtur në konsideratë se babai i saj ka pasur të ardhura të konsiderueshme nga tokat bujqësore në {***}, Shkodër, dhe i ka pasur të gjitha mundësitë të blejë apartamentet me sip. 74 m² dhe 47 m² me këto të ardhura.
7. Në analizën e kryer nga Komisioni për burimet e financimit të pasurisë apartamenti banimi me sip. 171 m² (*bashkimi i dy apartamenteve me sip. 88 m² + sip. 69m²*), të përfituar nëpërmjet kontratës së porosisë nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 07.11.2011, subjekti i rivlerësimit kundërshton si të padrejtë konkluzionin e Komisionit se ajo dhe babai i saj kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme për depozitimet e kryera në llogarinë dyemërore në BKT, në shumën 2.600.000 lekë.

8. Në drejtim të analizës tërësore financiare, subjekti i rivlerësimit kundërshton si të padrejta konkluzionet e vendimit të Komisionit, lidhur me: **(i)** huanë nga mbesa, në shumën 2.600 euro, të deklaruar në DVP-2004, duke pretenduar se nuk janë konsideruar qëndrimet e dhëna në ILDKPKI, në të cilat ka shpjeguar se kjo shumë ka qenë dhuratë e vëllait të saj; **(ii)** konsiderimin si pasuri të fshehur të subjektit të shumës 990.000 lekë, e cila është depozituar në *cash* nga nëna e saj në bankë, në janar 2017, pasi pretendon se kjo shumë është krijuar nga dhurimet e herëpashershme të shumave monetare që vëllai (djali) i ka dhuruar nënës.

B. Shkaqe ankimi lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe cenimin e besimit të publikut

9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në vendimin e Komisionit, mungon konkluzioni nëse subjekti ka arritur ose jo një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe pretendon se vlerësimi për cenimin e besimit të publikut duhet kryer veçmas, nëpërmjet një këndvështrimi gjithëpërfshirës, pa iu mbivendosur apo pa zëvendësuar konkluzionin mbi ndonjë prej tri kritereve të kontrollit.
10. Subjekti i rivlerësimit i konsideron si të padrejta konkluzionet e Komisionit, duke pretenduar se: **(i)** për procedimin penal nr. {***/2016, konstatimet e Komisionit nuk janë të drejta; **(ii)** për kallëzimet penale ndaj subjektit nr. {***/2014, nr. {***/2016, si dhe për procedimin penal nr. {***/2020, Komisioni nuk ka konsideruar se për një pjesë prej tyre është kaluar filtri i kontrollit të ILD-së, dhe se vendimmarrjet e subjektit janë konfirmuar nga gjykata; **(iii)** konkluzioni i Komisionit për procedimin penal nr. {***/2022, se ka vepruar në kundërshtim me parimin e paanësisë, si i vetëm, nuk mund të mjaftojë për të konkluduar se ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, pasi duhet vlerësuar duke aplikuar parimin e proporcionalitetit dhe të objektivitetit.
11. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ndonëse në vendimin e Komisionit mungon konkluzioni lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, rezulton se gjetjet e konstatuara në këtë kriter, janë përdorur në mënyrë të padrejtë për të konkluduar se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

a) Juridiksioni i Kolegjit

12. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për gjykimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit që ka vendosur për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

13. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma e gjykimit

14. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Subjekti i rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani, ka kërkuar në ankim që çështja e saj të gjykohej në seancë gjyqësore publike, për shkak të aplikimit të gabuar të ligjit, si dhe shkeljes së të drejtave kushtetuese, si ato të parashikuara nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

Në ankim, subjekti pretendon se Komisioni ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin pasi, sipas saj, *aplikimi i pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, kërkon në mënyrë kumulative kryerjen e një deklarimi të pamjaftueshëm për pasurinë dhe për kontrollin e figurës*. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues evidenton se në jurisprudencën⁵ e konsoliduar të Kolegjit tashmë është argumentuar qartësisht se ky pretendim nuk është i bazuar ligjërisht dhe, si i tillë, nuk mund të merret në konsideratë. Ky qëndrim i Kolegjit është konsideruar i drejtë edhe nga vendimmarrja e GjEDNJ-së në vendimin e dhënë për çështjen *A. Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, të datës 09.02.2021⁶.

14.1. Trupi gjykues konstaton se, në kushtet kur me ankimin, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur akte të reja dhe nuk identifikohen situata/prendime që evidentojnë shkelje të rënda procedurale gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision, çmon se nuk rezulton asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, të cilat do të diktonin shqyrtimin e kësaj çështjeje në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit. Për pasojë, shqyrtimi i çështjes u krye në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji

i. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

15. Trupi gjykues mori në shqyrtim dhe ia nënshtroi analizës shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, të cilat subjekti i rivlerësimit i ka identifikuar si arsye për të cilat duhej të vendosej ndryshimi i vendimit të Komisionit dhe konfirmimi i saj në detyrë.

15.1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani, kundërshton në tërësi metodologjinë e analizës financiare të kryer nga Komisioni për pasuritë apartament me sip. 74 m² dhe sip. 47 m², duke pretenduar se ajo nuk është e drejtë dhe e saktë, dhe si e tillë nuk pasqyron situatën faktike, pasi nuk ka konsideruar një sërë elementesh të cituara në paragrafin 6, më lart.

⁵ Shih vendimet e Kolegjit: (JR) 9/2018; (JR) 7/2019; (JR) 15/2019; (JR) 24/2020 etj.

⁶ Shih paragrafët 400-414 të vendimit.

15.2. Në funksion të shqyrtimit të shkaqeve të mësipërme të ankimit, trupi gjykues konstaton se në vendimin e Komisionit, lidhur me pasuritë e fituara nga subjekti përmes trashëgimisë ligjore të babait të saj, janë ngritur dyshime mbi pjesën takuese të fituar nga subjekti për pasuritë e regjistruara në emër të babait të saj. Në kushtet kur babai i subjektit i ka fituar ato gjatë martesës ligjore, Komisioni ka arsyetuar fillimisht se subjektit nuk i takonte të fitonte 1/3 pjesë të tyre, por 1/6 pjesë, duke konsideruar se nëna e saj ishte bashkëpronare në to në pjesën prej 1/2, si pasojë e bashkësisë ligjore. Pavarësisht kësaj analize, Komisioni ka konkluduar se regjistrimi në ASHK i pjesës prej 1/3 në pronësi të subjektit, është bërë në bazë të dëshmisë së trashëgimisë ligjore me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., të hartuar më datë 26.09.2016, dhe veprimet e regjistrimit nuk duhet të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, ndonëse jo në përputhje me ligjin. Pas kësaj analize, Komisioni, mbështetur në këtë panoramë, por dhe në vlerësim të një sërë rrethanash të tjera, ka ngritur dyshime dhe ka arritur në konkluzionin se këto pasuri janë në fakt pasuri të subjektit, të cilat ajo nuk i ka fituar nëpërmjet trashëgimisë ligjore.

15.3. Këtë konkluzion Komisioni e ka mbështetur kryesisht në argumentet se: (i) subjekti i rivlerësimit i ka përdorur këto apartamente që nga krijimi i tyre deri në kohën e deklarimit në deklaratën “vetting”, pra ka pasur një marrëdhënie të pandërprerë dhe të qëndrueshme me këto apartamente; (ii) vëllai i subjektit është me banim në Itali që prej vitit 1992 dhe këto pasuri nuk janë përdorur prej tij, përveç rasteve të ardhjes në Shqipëri; (iii) këto apartamente nuk kanë kaluar asnjëherë në pronësi të vëllait të saj si kontribuues i vetëm i krijimit të tyre, sikundër pretendon subjekti; (iii) subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se vëllai i saj, z. F. L., ka pasur të ardhura të mjaftueshme dhe kursime, të cilat i kanë shërbyer babait të saj për krijimin e dy pasurive apartament të sipërcituara. Për pasojë, Komisionit i krijohen dyshime të arsyeshme se pasqyrimi në kontratat e shitblerjes së apartamenteve në cilësinë e blerësit të babait të saj, e më pas deklarimi i subjektit të rivlerësimit në DPV-në e vitit 2016 dhe në deklaratën “vetting” 2017, se ky i fundit i ka blerë këto pasuri me paratë e dërguara nga vëllai i saj, janë deklarime të pabesueshme dhe të bëra me qëllim që të shmangej kontrolli i burimit të krijimit të këtyre pasurive.

Në përfundim, bazuar në analizën e rrethanave të mësipërme, trupi gjykues i Komisionit çmon se subjekti i rivlerësimi nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, pasi nuk shpjegoi bindshëm marrëdhënien me këto pasuri, duke u përpjekur të fshehë nga kontrolli apo verifikimi marrëdhënien e plotë të pronësisë mbi këto pasuri e, për pasojë, edhe burimet e krijimit të tyre, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

15.4. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si në Komision, ashtu edhe në ankim, analizën financiare për pasuritë apartament me sip. 74 m² dhe 47 m², duke pretenduar se përfitimi prej saj i 1/3 pjesë takuese të këtyre pasurive, është fituar nëpërmjet dëshmisë së trashëgimisë ligjore të lëshuar nga noteri, pas vdekjes së babait të subjektit, më datë 01.08.2016.

15.5. Për shqyrtimin e këtij shkak ankimi, trupi gjykues mori fillimisht në analizë aktin e emërtuar “Dëshmi e trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit F. L.” me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., i hartuar më datë 26.09.2016, nga notere B. T., i cili përcakton për trashëgimlënësin F. L.: (i) si trashëgimtarë në radhë të parë, thirren bashkëshortja dhe fëmijët; (ii) trashëgimlënësi ka lidhur vetëm një martesë, nga e cila ka dy fëmijë, dhe se bashkëshortja dhe fëmijët janë gjallë; (iii) trashëgimtarët ligjore të trashëgimlënësit F. L., përkatësisht bashkëshortja G. L., vajza Françeskina Lekani dhe djali F. L., trashëgojnë secili me 1/3 pjesë të pasurisë trashëgimore dhe mbartin detyrimin në të njëjtën masë.

15.6. Lidhur me pjesët takuese të trashëgimisë ligjore, në referim të përcaktimit të nenit 76 të Kodit të Familjes, në të cilin parashikohet se: “Pasuria e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak”, në kushtet kur të gjitha pasuritë e regjistruara në emër të trashëgimlënësit F. L. janë krijuar gjatë martesës me nënën e subjektit të rivlerësimit dhe nuk janë fituar me anë të dhurimeve apo trashëgimisë nga babai i subjektit, trupi gjykues e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit se pasuritë e krijuara gjatë martesës (në këtë rast, apartamentet me sip. 74 m² dhe 47 m²), *ipso lege* i përkasin me nga ½ pjesë, babait dhe nënës së subjektit. Për rrjedhojë, pasi babai i subjektit ka ndërruar jetë më 01.08.2016, vetëm ½ pjesë takuese e pasurisë (e cila është e gjitha e krijuar gjatë martesës) duhej t’i nënshtrohej regjimit të trashëgimisë ligjore. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të drejtë analizën ligjore që ka bërë Komisioni, lidhur me pjesën takuese të subjektit në këto pasuri, e cila ligjërisht duhej të ishte në masën prej 1/6 pjesë të saj.

15.7. Në këtë drejtim, trupi gjykues, duke vijuar analizën, konstaton se nga informacioni që ofron praktika e përcjellë në Komision nga ASHK-ja, dega Shkodër, rezulton se:

(i) Pasuria me nr. {***}, në zonën kadastrale nr. {***}, e llojit tokë arë me sip. 5.430 m², më datë 22.08.2002, fillimisht është regjistruar vetëm në pronësi të z. F. L. dhe, më datë 07.11.2016, kjo pasuri është regjistruar në emër të G. L. me 4/6 pjesë takuese, Françeskina Lekani me 1/6 pjesë takuese dhe F. L. po me 1/6 pjesë takuese.

(ii) Pasuria me nr. {***}, në zonën kadastrale nr. {***}, e llojit tokë arë, me sip. 2.715 m², më datë 24.02.2003, fillimisht është regjistruar vetëm në pronësi të z. F. L. (i cili këtë pasuri, me akt shitjeje, e ka blerë nga shtetasi A. L. me çmimin 50.000 lekë më datë 01.02.2003) dhe, më datë 07.11.2016, kjo pasuri është regjistruar në emër të G. L. me 1/3 pjesë takuese, Françeskina Lekani me 1/3 pjesë takuese dhe F. L. po me 1/3 pjesë takuese.

(iii) Në praktikën e ASHK-së, dega Shkodër, me nr. {***} prot., datë 19.10.2023, është përcjellë në Komision kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.09.2011, me të cilën babai i subjektit, z. F. L., në cilësinë e porositësit, ka porositur te sipërmarrësi, shoqëria e ndërtimit “{***}” ShPK, dy apartamente banimi në katin e dytë, me sip. 88 m² dhe me sip. 69 m², në godinën që po ndërtohej nga kjo shoqëri në lagjen “{***}”, Shkodër, kundrejt çmimit 103.000 euro, nëse punimet e brendshme të dy apartamenteve realizohen nga porositësit, dhe me çmimin 113.000 euro, nëse punimet e brendshme realizohen nga sipërmarrësi, shoqëria e ndërtimit “{***}” ShPK. Në këtë praktikë të ASHK-së Shkodër, gjendet shkresa nr. {***} prot., datë 26.01.2022, me anë të së cilës ky institucion i bën me dije subjektit Françeskina Lekani se, në përgjigje të kërkesës së saj nr. {***}, datë 01.12.2021, me anë të së cilës kërkon lëshimin e certifikatës së pronësisë për këto apartamente, për të cilat ka depozituar edhe dëshminë e trashëgimisë ligjore të të ndjerit F. L., kërkohet të paraqesë edhe mandatpagesën e regjistrimit të dëshmisë së trashëgimisë, duke i bërë me dije se, për këtë apartament, është lëshuar leja e legalizimit në emër të z. F. L. Më pas, rezulton se ASHK Shkodër, më datë 07.11.2016, ka lëshuar kartelën e pasurisë së paluajtshme për pasurinë me nr. {***}, me sip. 74 m², në të cilën figurojnë bashkëpronarë: G. L., Françeskina Lekani dhe F. L., pa përcaktuar pjesët takuese, por me shënimin: *dëshmi e trashëgimisë ligjore {***}, datë 26.09.2016.*

(iv) Në praktikën e ASHK Shkodër, me nr. {***} prot., datë 19.10.2023, është përcjellë në Komision edhe kartela e pasurisë së paluajtshme për pasurinë apartament me sip. 171,3 m², me nr. {***} (e krijuar nga bashkimi i apartamenteve të mësipërme me sip. 88 m² + ap. me sip. 69 m²), në të cilën figurojnë bashkëpronarë G. L. me 1/3 pjesë takuese, Françeskina Lekani me 1/3 pjesë takuese dhe F. L. po me 1/3 pjesë takuese.

15.8. Nga sa referuar më sipër, rezulton se nga ASHK Shkodër, përcaktimet e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin F. L., ndryshe janë regjistruar për sa i përket përcaktimit të pjesës takuese në rastin e tokës arë, dhe ndryshe janë regjistruar në rastin e regjistrimit të apartamenteve. Situata lidhur me pasaktësitë në përcaktimin e pjesëve takuese nga trashëgimia ligjore, pavarësisht se është vërejtur nga Komisioni, duket se nuk ka shërbyer si një shkak autonom për të ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit (ato kanë mbetur si mangësi që i janë ngarkuar ASHK-së), por duket se ka shërbyer si indicie që lidhen me të drejtat e vërteta të subjektit mbi to, siç mund të lexohet në vijim të këtij arsyetimi. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se ngritja e këtyre pretendimeve nga subjekti në ankim, rezulton pa relevancë në drejtim të kundërshtimit të vendimit të Komisionit, për sa kohë që këto konkluzione nuk e kanë ngarkuar atë me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për zbatim të gabuar të ligjit. Pavarësisht këtij qëndrimi të Komisionit, analiza e mësipërme, siç u përmend, ka ndikim në vlerësimin e të gjitha rrethanave të tjera të përdorura prej Komisionit për të arritur në konkluzionet për mënyrën e fitimit të pasurive. Dhe, pikërisht në këtë kontekst, trupi gjykues vlerësoi t'i rendisë si më lart argumentet e përmendura. Për rrjedhojë, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, konsideroi të nevojshme kryerjen e kontrollit të analizës financiare lidhur me burimet e ligjshme të financimit të apartamenteve me sip. 47 m² dhe sip. 74 m², nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj e origjinës.

15.9. Në vijim, trupi gjykues, lidhur me apartamentet me sip. 74 m² dhe sip. 47 m², të ndodhura në Shkodër, mori në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit se analiza financiare e kryer nga Komisioni është e pasaktë, pasi: **(i)** në mënyrë të padrejtë, vëllai i subjektit është konsideruar si person i lidhur me të; **(ii)** nuk është konsideruar se nga viti 1992 e deri në vitin 1995, vëllai i subjektit të rivlerësimit, së bashku me bashkëshorten kanë punuar në emigracion, Itali, pa dokumente; **(iii)** nuk është mbajtur në konsideratë se babai i saj ka pasur të ardhura të konsiderueshme nga tokat bujqësore në fshatin {***}, Shkodër, dhe i ka pasur të gjitha mundësitë t'i blejë me këto të ardhura këto pasuri.

15.10. Komisioni ka marrë në analizë të ardhurat e vëllait të subjektit si burim për krijimin e tri pasurive të regjistruara në emër të babait, duke qenë se vetë subjekti ka deklaruar gjatë hetimit administrativ, se ai ka kontribuar thelbësisht si financues për krijimin e tyre. Nga analiza financiare për vëllain e subjektit, z. F. L., është konstatuar dhe konkluduar sa vijon:

*Komisioni kreu analizën financiare për periudhën shtator 2001 – dhjetor 2004. Duke marrë në konsideratë lidhur me mundësitë e vëllait të subjektit për blerjen e apartamentit me sip. 47 m² në vitin 2004. Duke marrë në konsideratë se ky shtetas ka në përbërje familjare bashkëshorten dhe tri vajzat, Komisioni përlllogariti shpenzimet e jetesës për familje me tri fëmijë. Sa më sipër, Komisioni pasqyroi në analizën financiare: **(i)** të ardhurat bruto në shumën 34.577 euro; **(ii)** shpenzimet e jetesës në shumën 43.984 euro, sipas tabelës vijuese. Sa më lart, Komisioni konstaton se të ardhurat e ligjshme të shtetasit F. L. nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës dhe, për pasojë, përjashtohet mundësia për të pasur burime të ligjshme për blerjen e apartamentit me sip. 47 m², në datën 23.1.2004.*

15.11. Trupi gjykues mori fillimisht në shqyrtim pretendimin e subjektit se, duke qenë se vëllai i saj nuk gëzonte asnjë status në kontekstin e këtij procesi, si person i lidhur apo tjetër i lidhur, analiza financiare për të ardhurat e tij ishte joproporcionale. Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues mbajti në konsideratë deklaratimet e vetë subjektit rreth kontributit të vëllait të saj për krijimin e këtyre pasurive, si dhe nevojës së lindur prej Komisionit për të verifikuar këto burime, nevojë e lindur nga dyshimet për pasuri të fshehur të subjektit, në analizë të një sërë rrethanash të arsyetuara në vendim

e të bëra prezente edhe subjektit nëpërmjet rezultateve paraprake të hetimit. Nga këto deklarime të subjektit, rezulton se:

(i) Në deklaratën e pasurisë *vetting*, për pasuritë apartament banimi me sip. 47 m² dhe sip. 74 m², subjekti deklaroi se i ka trashëguar sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore të babait, z. F. L., i cili i ka blerë ato me paratë e dërguara nga djali i tij F. L.

(ii) Në Deklaratën Periodike Vjetore (në vijim DPV) të vitit 2016, për këto pasuri, subjekti ka deklaruar njësoj si në deklaratën e pasurisë *vetting*, si të fituara nga trashëgimia ligjore e babait, i cili i ka krijuar ato me të ardhurat e dërguara nga F. L. (vëllai i subjektit).

15.12. Nga sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se, me të drejtë, Komisioni ka orientuar hetimin drejt kontrollit të këtyre burimeve, pasi: (i) vetë subjekti e ka potencuar vëllain e saj si financues të pasurive, të cilat janë fituar më pas prej saj; (ii) trashëgimia ligjore është zbatuar në mënyrë jo të saktë për sa u takon pjesëve takuese, duke favorizuar subjektin, për shkak të mospërcaktimit në mënyrën e duhur të pjesës takuese sipas dispozitave ligjore në fuqi, e cila duhej të ishte sa 1/6 e pasurive, ndërsa subjekti ka fituar 1/3 e tyre; (iii) kjo ndarje nuk është kundërshtuar nga vëllai i subjektit që, sipas deklarimeve të saj, ka qenë kontribuuesi/financuesi i vetëm për krijimin e këtyre pasurive, rrethanë që në një situatë normale do të duhej të kishte përcaktuar atë vetë si përfituesin më i madh të tyre; (iv) subjekti i rivlerësimi i ka përdorur këto pasuri në mënyrë të vazhdueshme, e pakushtëzuar nga bashkëpronarët e tjerë.

Në vlerësimin e trupit gjykues, situata e mësipërme ka diktuar ushtrimin prej Komisionit të kompetencës së kontrollit dhe verifikimit të burimit të krijimit të pasurive në pronësi të subjektit të rivlerësimi, në zbatim të përcaktimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si edhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

15.13. Në këtë kuptim, duke iu referuar jurisprudencës së Kolegjit⁷, pretendimi i subjektit të rivlerësimi se vëllai i saj, z. F. L., nuk e ka cilësinë e personit tjetër të lidhur dhe, për pasojë, ajo nuk ka detyrimin për të provuar burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë prej tij, vlerësohet nga trupi gjykues si jorelevant në situatën konkrete, pasi hetimi drejt burimeve të të ardhurave të tij, nuk është zhvilluar mbështetur mbi këtë parashikim ligjor, por mbi dyshimin se pasuria është *de facto* e subjektit të rivlerësimi, dyshim që legjitimon hetimin dhe shtrin detyrimin mbi subjektin e rivlerësimi përtej kufijve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016⁸.

⁷ Shih vendimet e Kolegjit nr. 21/2020 (JR); nr. 15/2019 (JR) dhe nr. 52/2023 (JR).

⁸ Me rezultatet e hetimit administrativ, në lidhje me apartamentet me sip. 47 m² dhe sip. 74 m², të blera nga babai i subjektit në vitin 2004, Komisioni i ka kaluar subjektit barrë prove, lidhur me konstatimet se:

“Ka dyshime mbi vërtetësinë e deklaratimit të subjektit se ajo është bashkëpronare me nënën dhe vëllain e saj në pasuritë apartament me sip. 47 m² dhe apartament me sip. 74 m², duke u përpjekur të paraqesë rrethana të rreme, të cilat tentojnë të shmangin nga kontrolli një marrëdhënie të një natyre tjetër, që është ajo e pronësisë së plotë për këto pasuri, pasi:

- i. Subjekti ka banuar në këto apartamente që nga momenti i blerjes së pasurisë (në kushtet kur subjekti ka deklaruar se apartamentet janë ngjitur dhe kanë pasur derë komunikuese⁸).
- ii. Subjekti figuron bashkëpronare në 1/3 e kësaj pasurie, ndërkohë që, sipas dispozitave ligjore në fuqi, duhej të figuronte me 1/6 pjesë.
- iii. Pas regjistrimit të dëshmisë së trashëgimisë të babait të saj, subjekti figuron bashkëpronare në 1/3 e këtyre pasurive, ndërkohë që, sipas deklaratimit, kontribuues i vetëm në blerjen e tyre, është vëllai i subjektit.
- iv. Nuk duket bindës shpjegimi i subjektit mbi arsyet e mosregjistrimit të këtyre pasurive në emër të vëllait, në kushtet që, sipas deklaratimit, ai është kontribuues i vetëm në blerjen e tyre.
- v. Të ardhurat e ligjshme të vëllait të subjektit nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës për familjen e tij dhe, për pasojë, përjashtohet mundësia për të pasur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

15.14. Për rrjedhojë, në Kolegj, ashtu si edhe në Komision, analiza financiare e vëllait të subjektit u realizua duke iu referuar të gjithë të ardhurave dhe shpenzimeve apo investimeve të kryera prej tij, për të cilat ishin administruar të dhëna nga hetimi administrativ.

15.15. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se, në analizën financiare të kryer për dy apartamentet në Shkodër, me sip. 74 m² dhe sip. 47 m², nuk janë përfshirë padrejtësisht të ardhurat e vëllait të subjektit dhe të bashkëshortes së tij, të siguruara nga puna *në të zezë* në emigracion, në vitet 1992-1995, trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht se të ardhurat nga emigracioni kanë qenë një realitet historik i shoqërisë shqiptare, për efekt të këtij procesi, ato duhet t'i nënshtrohen kontrollit mbi standardin e të ardhurës së ligjshme, sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, ashtu si edhe ka përcaktuar jurisprudenca e këtij Kolegji në mënyrë të qëndrueshme tashmë⁹. Trupi gjykues konstaton se, referuar këtyre të ardhurave, pikësëpari, pretendimet e subjektit të rivlerësimit kanë mbetur në nivel deklarativ që në drejtim të provueshmërisë së ekzistencës së tyre, pasi subjekti jo vetëm që nuk ka mundur të provojë ndonjë element të punësimit të vëllait të saj në Itali, dhe as është kujdesur për të deklaruar vlerën mujore apo vjetore të përfutur prej tij, por as ka identifikuar masën e parave të kursyera nga puna *në të zezë* gjatë periudhës së marrë në analizë.

15.16. Në vijim, lidhur me të ardhurat nga emigracioni të vëllait të subjektit, në periudhën 1996 - 2001, trupi gjykues konstaton se nga kontrolli i analizës së Komisionit për këtë periudhë, rezulton se në parim, metodologjia e përdorur është e drejtë dhe mbështetet në jurisprudencën e Kolegjit. Në këtë analizë financiare të kryer nga Komisioni, rezulton se vlerat e konsideruara si “të ardhura” janë marrë nga konfirmimi zyrtar i lëshuar¹⁰ nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore i shtetit italian për shtetasin F. L., për vitet respektive të analizës, ndërsa përllogaritja e shpenzimeve është bazuar në të dhënat e marra nga faqja zyrtare e Eurostat, në të cilën janë publikuar të dhënat e shpenzimeve për kosto jetese të familjeve me 4 pjesëtarë (2 të rritur dhe dy fëmijë nën 14 vjeç) në *nivel varfërie*. Në përllogaritjet e kryera nga Komisioni, pas verifikimit të tyre në Kolegj, janë korrigjuar shpenzimet e jetesës për vitet 1996, 1997 dhe 1998, në të cilat, nga Komisioni, është aplikuar jo korrekt numri i pjesëtarëve të familjes së vëllait të subjektit, z. F. L. Në përllogaritjet e kryera në Kolegj nga Njësia e Shërbimit Ligjor, është korrigjuar numri i pjesëtarëve të familjes sipas datave të ardhjes në jetë të fëmijëve, respektivisht për vitet 1996-1997, familje me 3 persona¹¹, ndërsa për vitin 1998, për shkak të ardhjes në jetë të fëmijës së dytë¹² më datë 13.10.1998, familja është konsideruar e përbërë nga 4 persona.

15.17. Pavarësisht korrektimeve në drejtim të përllogaritjes së shpenzimeve të jetesës, si më lart përshkruar, trupi gjykues konstatoi sërish se situata financiare e familjes së vëllait të subjektit, z. F.

vi. *Duket e dyshimtë blerja nga ana e vëllait të subjektit e disa pasurive të paluajtshme në Shkodër, pasuri të cilat as nuk përdoren nga ana e tij dhe as nuk gjenerojnë të ardhura.*

Në momentin e blerjes së kësaj pasurie, subjekti figuronte në certifikatë familjare me babain e saj (blerësi i kësaj pasurie) dhe jetonte faktikisht me të”.

⁹ Shih vendimet e Kolegjit: nr.12/2018 (JR); nr. 8/2024 (JR); nr. 13/2020 (JR).

¹⁰ Vërtetim i lëshuar më datë 14.03.2023, me referencë {***}, nga INPS (institucioni i shtetit italian që merret me përllogaritjen e kontributeve të punëdhënësit e punëmarrësit për pension pleqërie).

¹¹ Vëllai i subjektit ka 3 vajza (I. L., datëlindje. 11.11.1994; F. L., datëlindje. 13.10.1998; F. L., datëlindje 24.2.2001).

¹² F. L.

L., për periudhën 1996-2001, rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për të krijuar dhe akumuluar kursime në funksion të blerjes së apartamenteve në Shkodër.

15.18. Për pasojë, në kushtet kur, me ankimin, subjekti nuk ka mundur të paraqesë asnjë të dhënë tjetër përtej atyre që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ në Komision për të ardhurat e ligjshme të vëllait të saj në kohën e blerjes së apartamenteve, trupi gjykues arrin në konkluzionin se analiza financiare e Komisionit, si dhe konkluzioni i vendimit se vëllai i subjekti të rivlerësimit gjendej në pamundësi financiare¹³ për të financuar me të ardhura të ligjshme blerjen e dy apartamenteve në Shkodër, me sip. 74 m² dhe sip. 47 m², është një konkluzion i drejtë, i mbështetur në fakte dhe në ligj.

15.19. Në vijim, analiza e trupit gjykues u ndal në pretendimin e subjektit të rivlerësimit, *se pjesë e analizës financiare për kontrollin e burimeve të krijimit të pasurisë apartament me sip. 74 m² dhe apartament me sip. 47 m², nuk është konsideruar fakti që babai i subjektit ka pasur të ardhura më se të mjaftueshme nga prodhimet e tokës bujqësore në fshatin {***}, të ardhura të cilat ishin të konsiderueshme për të përballuar blerjen e këtyre apartamenteve, duke arsyetuar sa vijon.*

15.20. Trupi gjykues konstaton se ky pretendim i subjektit që është paraqitur për herë të parë me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, duket në tentativën për të shmangur përgjegjësinë për mungesën e burimeve të vëllait të saj për blerjen e pasurive në Shkodër në emër të babait, në të cilat ajo ka deklaruar se: *Si përfundim, lidhur me këtë pjesë dhe aludimet se pasuritë e blera nga vëllai im në vitin 2001 dhe vitin 2004 me të ardhura të emigracionit, të regjistruara në emër të babait tim, janë pasuri të fshehura të miat, sqaroj se nga ana ime nuk ka qenë aspak e nevojshme të bëj një lëvizje të tillë pasi në periudhën në fjalë, nga viti 1993 deri në vitin 2001, babai im ka gjeneruar të ardhura nga prodhimet e tokës bujqësore me sipërfaqe 5,5 dynymë në fshatin {***}, në vlerën 4.547.072 lekë, dhe nga vitit 2002 deri në vitin 2004, në vlerën 757.845 lekë.*

15.21. *Së pari*, nga analizimi i këtyre deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se ky qëndrim i subjektit bie ndesh me deklaratimet e bëra prej saj në deklaratën e pasurisë *vetting*, në të cilën për asnjë pasuri nuk ka deklaruar si burim financimi të ardhurat e siguruar nga shfrytëzimi i tokës bujqësore në fshatin {***}, për rrjedhojë, e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit që e përcakton ndryshimin e deklarimit si një përpjekje për të shtuar burimet e financimit të pasurive të paluajtshme.

15.22. *Së dyti*, në konsideratë të këtij pretendimi, konstatohet se për të provuar të ardhurat nga toka bujqësore në fshatin {***}, Shkodër, subjekti ka paraqitur në Komision “Akt vlerësimi”, bërë nga Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Shkodër, nr. {***} prot., datë 05.10.2023. Nga analizimi i të dhënave të këtij akti dhe i provave të tjera administruara nga hetimi administrativ, rezulton se:

(i) Me anë të kërkesës së datës 04.10.2023, subjekti i rivlerësimit i kërkon Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Shkodër, kryerjen e një akt vlerësimi për sipërfaqen e tokës bujqësore me sip. 5.500 m² vresht në prodhim, që nga viti 1993 e deri në vitin 2017, duke kërkuar të llogaritet fitimi neto i realizuar në këtë periudhë. Në këtë kërkesë, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument provues bashkëlidhur.

¹³ Nga përllogaritjet e kryera në Kolegj pas korrektimit të numrit të pjesëtareve të familjes së vëllait të subjektit, situata financiare e vëllait të subjektit të rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh në shumën (-) 9.407 euro për periudhën shtator 2001 - dhjetor 2003, që korrespondon me blerjen e pasurisë apartament me sip. 74 m², më datë 15.09.2001, në vlerën 150.000 lekë, si dhe në shumën (-) 28.208 euro për periudhën korrik 1996 - gusht 2001, që korrespondon me blerjen e pasurisë apartament me sip. 47 m², më datë 23.01.2004, në vlerën 600.000 lekë.

(ii) Në përgjigje të kësaj kërkesë, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Shkodër, me anë të shkresës nr. prot. {***}, datë 05.10.2023, të emërtuar “Akt vlerësimi”, referon se familja bujqësore e përbërë nga F. L., G. L., Françeskina Lekani dhe F. L., nga toka bujqësore në {***}, Shkodër, me sip 5.500 m², për periudhën nga viti 1993 e deri me 30.09.2017, kanë siguruar të ardhura neto nga shitja e prodhimit për një periudhë 25-vjeçare, prej 6.315.375 lekësh. Në këtë praktikë gjendet një përlllogaritje e bërë për të ardhurat e siguruar nga toka në çdo vit deri në vitin 2017.

15.23. Për sa më lart, konstatohet se: (i) ka qenë subjekti që i ka kërkuar AREB Shkodër, të kryejë një akt vlerësimi për të ardhurat të gjeneruara nga toka në pronësi të familjes, e mbjellë me vresht, pa i paraqitur asnjë akt që provon ekzistencën e vreshtit dhe as periudhën nga e cila ai ekziston. Tek Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)¹⁴ me nr. regjistri nr. {***} akti, i cili nuk ka datë, rezulton se kryefamiljarit, z. F. L.¹⁵, i është dhënë 5.500 m² tokë arë, *pa pemëtore, pa vresht, pa ullishte*. Gjithashtu, në kontratën noteriale të shitjes së kësaj prone me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 01.08.2017, nga subjekti i rivlerësimit, nëna dhe vëllai i saj, përshkruhet shitja e një sipërfaqeje toke arë prej 5.500 m², por pa u specifikuar se kjo sipërfaqe është e mbjellë me vresht; (ii) nga analizimi i përmbajtjes së aktit të vlerësimit, rezulton se ai është bërë duke marrë të mirëqenë vetëm sipas deklarimeve të subjektit, faktin që ekziston *një vresht me sip. 5.500 m²*, i mbjellë që nga viti 1993, për të cilin mënyra e përlllogaritjes së shpenzimeve dhe e fitimit duket të jetë e njëjta për 25 vite. Në këtë akt vlerësimi nuk jepen shpjegime se nga janë marrë të dhënat për shpenzimet dhe fitimet dhe përse ato janë të njëjta për çdo vit. Në këtë akt vlerësimi, nuk referohet asnjë informacion që jep të dhëna të kohës kur janë krijuar prodhimet, siç mund të jenë aktkontrolle apo evidenca të tjera të Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër, të cilat mund të kishin shërbyer si bazë e besueshme për vlerat e përfshira në këtë akt; (iii) në aktin e vlerësimit evidentohet se pjesë e familjes bujqësore ka qenë dhe subjekti i rivlerësimit, rrethanë që diktonte detyrimin e saj për deklaram, si subjekt deklarues i pasurisë ndër vite jo vetëm të bashkëpronësisë në tokat e përfituara nga ligji nr. 7501 i vitit 1991, “Për tokën”, por edhe i çdo të ardhure të siguruar nga zhvillimi i saj. Po ashtu, rezulton se e ardhura nga pjesa takuese e tokës bujqësore (vreshtit) nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, as nga subjekti i rivlerësimit dhe as nga nëna e saj; (iv) në shpjegime, ndonëse subjekti pretendon se të ardhurat nga toka bujqësore i ka siguruar babai i saj, ajo nuk jep shpjegime nëse ka qenë babai¹⁶ që ka investuar dhe punuar në vresht, apo mbarëvajtja e tij është kryer nga të tretë, apo është dhënë me qira; (v) subjekti nuk ka arritur të provojë as pagesën e taksës së tokës bujqësore, e cila është detyrim ligjor që rrjedh për shkak të të drejtave të pronësisë/bashkëpronësisë¹⁷.

15.24. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues konstaton se i gjithë informacioni që ofron ky akt, duket se është një përlllogaritje empirike lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e mundshme të një vreshti, për të cilin nuk ka asnjë gjurmë dokumentare për ekzistencën, sasinë e prodhimit të marrë, shitjen e prodhimit, të ardhurat e siguruar, si dhe për shpenzimet e kryera lidhur me të. Për të gjitha

¹⁴ Të përcjellë në Komision nga AShK Shkodër, bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 31.07.2023.

¹⁵ Këtë mbiemër ka në AMTP.

¹⁶ Në këtë drejtim, evidentojmë faktin se babai i subjektit ka qenë i datëlindjes 04.06.1938 dhe ka ndërruar jetë në vitin 2016, në moshën 78-vjeçare, moshë relativisht e avancuar për të punuar në vreshtari, në një sipërfaqe 5.500 m².

¹⁷ Në faqen zyrtare në internet të Ministrisë së Financave për taksën e tokës bujqësore informohet se:

“Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore në hektarë, në pronësi të tatimpaguesit. Pronësia e këtyre tokave bujqësore përcaktohet në dokumentet që e vërtetojnë atë. Niveli i taksave për çdo kategori minimale të bazës së taksës dhe kategoritë minimale të tokës bujqësore jepen si më poshtë [...]”.

Shih: <https://arkiva.financa.gov.al/taksa-mbi-token-bujqesore/>

këto arsye, trupi gjykues e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit që nuk ka konsideruar në analizë financiare të ardhurat e pretenduara se janë krijuar nga zhvillimi i tokës bujqësore, si të paprovuara e të mbetura në nivel deklarativ dhe, si të tilla, ato u trajtuan edhe në analizën financiare në Kolegj.

15.25. Në konsideratë të analizës lidhur me këto pasuri, trupi gjykues vlerëson të sjellë në vëmendje edhe konstatimin e Komisionit lidhur me çmimet e blerjes së këtyre apartamenteve, të cilat sugjerojnë vera jo reale të blerjes së tyre. Në këtë kontekst, sipas konstatimeve të Komisionit, *çmimet e shitjes të pasqyruara në kontratat e shitblerjes jo vetëm që nuk përputhen me vlerën mesatare në tregun e lirë të banesave, por janë jologjike, pasi apartamenti me sip. 74 m² është blerë në vitin 2001 në shumën 150.000 lekë, ndërsa apartamenti me sip. 47 m², pas 3 viteve nga blerja e apartamentit të parë, duke pasur një sipërfaqe më të vogël, në të njëjtin pallat, është blerë në shumën 600.000 lekë, ndërkohë që, sipas të dhënave të EKB-së¹⁸, nuk rezulton që çmimet në tregun e lirë të banesave në qytetin e Shkodrës të kenë pësuar ndryshime thelbësore gjatë viteve 2001 – 2004.* Këto gjetje sugjerojnë për mungesa të burimeve financiare më të larta në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, në rast se analiza financiare do të kryhej mbi bazën e çmimeve të tregut apo çmimeve të arsyeshme për blerjen e tyre. Kjo situatë e cila nuk duket se ka pasur një pasojë të drejtpërdrejtë në raport me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, sipas vendimit të Komisionit, jep sidoqoftë indicie rreth nivelit të paligjshmërisë në krijimin e këtyre pasurive, i cili afekton vlerësimin në tërësi të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

15.26. Në përfundim, në përmbledhje të arsyetimit të mësipërm, për pasuritë apartamente me sip. 74 m² dhe sip. 47 m², të ndodhura në Shkodër e të deklaruar prej subjektit të rivlerësimit si në bashkëpronësi me pjesë takuese prej 1/3 në deklaratën *vetting*, trupi gjykues arriti në konkluzionin se është i drejtë vlerësimi i Komisionit se subjekti është përpjekur të fshehë marrëdhënien e vërtetë të saj me këto pasuri, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016. Në këtë konkluzion, trupi gjykues mbajti në konsideratë një sërë elementesh të analizuar edhe nga Komisioni, por jo vetëm, si: **(i)** faktin që subjekti i ka poseduar ato gjatë gjithë kohës, ndërsa financuesi i pretenduar, vëllai i saj, ka jetuar pa ndërprerje në Itali, duke e gjetur të paarsyeshëm këtë investim nga ana e tij; **(ii)** faktin që vëllai i subjektit, i deklaruar prej saj në deklaratën *vetting* si financues i pasurive, nuk rezulton të ketë pasur të ardhura të ligjshme as për të mbuluar shpenzimet jetike të tij dhe familjes për periudhën e marrë në analizë, referuar standardit të të ardhurave të ligjshme, sipas parashikimit të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016; **(iii)** përpjekjen e subjektit për të shtuar burime të reja të krijimit të kësaj pasurie gjatë hetimit administrativ, si të ardhurat e krijuara prej babait të saj nga aktiviteti bujqësor, të cilat nuk janë deklaruar si të tilla as në deklaratën *vetting* dhe as në deklaratat periodike të subjektit në vite, e që për më tepër as që provohen se janë krijuar, sipas një analize objektive, të kryer mbi bazë dokumentare; **(iv)** çmimet e këtyre pasurive, dukshëm fiktive, që nuk u për afrohen aspak as kostove të ndërtimit në qytet në kohën e blerjes së tyre dhe as vlerave të tjera që subjekti deklaroi se janë përfituar prej shitjes së pasurisë të saj në fshat, të cilat as nuk janë regjistruar në regjistrat publikë. Të gjitha rrethanat e mësipërme konfirmojnë konkluzionin se subjekti gëzon në mënyrë të plotë këto pasuri dhe se këto të drejta nuk i ka fituar siç ajo deklaroi, nëpërmjet trashëgimisë ligjore.

¹⁸ Nga të dhënat për vlerën mesatare të apartamenteve në tregun e lirë të banesave për qytetin e Shkodrës, rezulton se për vitin 2001, kur është blerë apartamenti me sip. 74 m², vlera e tregut për këtë pasuri përlllogaritet 2.818.438 lekë dhe për vitin 2004, kur është blerë apartamenti me sip. 47 m², vlera e tregut për këtë pasuri përlllogaritet në 2.117.491 lekë. Shih: <https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit/>

16. Në vijim, trupi gjykues i Kolegjit shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, *lidhur me analizën e kryer nga Komisioni për burimet e financimit të pasurisë apartament banimi në Shkodër, me sip. 171 m² (bashkim i 2 ap. me sip. 88 m² + 69 m²), të përfutur nëpërmjet kontratës së porosisë nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 07.11.2011, dhe konkluzionin e Komisionit se ajo dhe babai i saj kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme për depozitimet e kryera në funksion të pagesës së apartamentit, në llogarinë dyemërore në BKT, në shumën 2.600.000 lekë, të cilat i konsideron të padrejta dhe të pabazuara në prova, duke analizuar sa vijon.*

16.1. Në vendimin e Komisionit lidhur me depozitimet e kryera nga subjekti dhe babai i saj në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT), të cilat kanë shërbyer për financimin e apartamentit të deklaruar prej saj në deklaratën e pasurisë *vetting*, është analizuar dhe konkluduar se subjekti i rivlerësimit: (i) ka deklarime kontradiktore lidhur me porositjen e apartamenteve në vitin 2011; (ii) nuk ka deklaruar pjesën e saj takuese në këto apartamente, duke qenë se ka marrë dhe kredi për pagimin e kështit në shumën 3.500.000 lekë; (iii) nuk provoi bindshëm ekzistencën e të ardhurave të ligjshme të babait të saj për pagesën e kryer në vitin 2011; (iv) nuk provoi plotësisht burimet e ligjshme për shumën 5.000 euro, paguar në vitin 2012; (v) ka poseduar apartamentin në vitin 2017, edhe pse nuk kishte shlyer më shumë se 50% të vlerës së kontratës; (vi) ka pushuar hetimin në ngarkim të investitorit të apartamentit në kushtet e një marrëdhënieje detyrimi të pashlyer, pra në kushtet e konfliktit të interesit. Në vlerësimin tërësor të këtyre rrethanave, arrihet në përfundimin se këto pasuri janë të subjektit të rivlerësimit dhe nuk janë deklaruar me vërtetësi në deklaratën “vetting” 2017 dhe ato periodike. Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë në deklaratën “vetting” 2017, bashkëpronësinë me 1/3 pjesë nga trashëgimia ligjore e babait të saj në pasuritë apartament me sip. 88 m² dhe sip. 69 m², duke u përpjekur të fshehtë nga kontrolli apo verifikimi marrëdhënien e plotë të pronësisë mbi këto pasuri e, për pasojë, edhe burimet e krijimit të tyre, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

16.2. Për shqyrtimin e këtij shkak ankimi, trupi gjykues mori në analizë deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, në DVP-të, si dhe të dhënat që rezultojnë nga aktet e marrë gjatë hetimit administrativ në Komision, nga të cilat konstaton se:

(i) Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Dy apartamente banimi me sip. 88 m² e 69 m², të paregjistruara, por me kontratë sipërmarrjeje nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 7.9.2011, ku porositës është i ndjeri, babai im F. L. Për të cilin ka paguar vetëm një kësht. Si burim krijimi deklaron: Të ardhurat nga shitja e banesës në fshatin {***}, Njësia Administrative {***}, të cilën e kemi të paregjistruar, por të shitur me një deklaratë, ndërtuar para viteve ‘90, si dhe nga kredia e marrë në BKT. Vlera 60.000.000 lekë¹⁹ (trashëgimtar pas shlyerjes së detyrimit e regjistrimit).*

(ii) Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstaton se apartamenti me sip. 171m², origjinën e tij e ka nga kontrata e sipërmarrjes nr. nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 7.9.2011, me anë të së cilës porositësi, babai i subjektit, z. F. L., ka porositur te shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK, dy apartamente banimi me sip. 88 m² dhe 69 m², të dy me pozicionim në katin e dytë teknik të objektit, duke u dakordësuar për çmimin e shitjes në total për të dy apartamentet, në shumën 103.000 euro, në rast se të gjitha punimet e brendshme do të realizohen nga porositësi, dhe në shumën 113.000 euro, në rast se të gjitha punimet e brendshme do të kryhen nga shoqëria sipërmarrëse

¹⁹ Kjo vlerë e deklaruar duket se ka një lapsus.

“{***}” ShPK. Po ashtu, kontrata noteriale e sipërmarrjes përcakton se kësti i parë, në shumën 2.000.000 lekë, është paguar jashtë zyrës noteriale me nënshkrimin e kësaj kontrate, dhe se pjesa e mbetur do të paguhet sipas marrëveshjes së vetë palëve.

(iii) Nga praktika e administruar prej Komisionit nga ASHK Shkodër²⁰, me shkresën nr. {***} prot., datë 19.10.2023, informohet se, me vendimin nr. {***}, datë 13.10.2021, të ALUIZNI-t, është nxjerrë leje për legalizimin e objektit pa leje, të llojit “objekt me shkelje të lejes së ndërtimit”, të poseduar nga z. F. L., me sipërfaqe ndërtimi 171,3 m² me përshkrimin “njësi banimi”, në katin e dytë, në një “godinë banimi dhe shërbimi 3kt + nënçati të shfrytëzuar”, në thyerje të lejes së ndërtimit”. Mbi bazën e këtij vendimi për legalizimin e objektit pa leje, të kontratës noteriale të sipërmarrjes nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 7.9.2011, si dhe në aplikim të përcaktimeve të dëshmisë së trashëgimisë ligjore (çështje e trajtuar më sipër), subjekti i rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani, së bashku me vëllain F. L. dhe nënën G. L., sipas “Certifikatës së regjistrimit të pronësisë”, me kod unik {***}, që prej të datës 01.12.2021, figurojnë bashkëpronarë me 1/3 pjesë takuese të apartamentit me sip. 171,3 m², në zonën kadastrale {***}, Shkodër.

16.3. Trupi gjykues, referuar në këto akte, konstaton se subjekti dhe familjaret e saj, mbi bazën e një leje legalizimi, kanë fituar pronësinë mbi një apartament të vetëm me sip. 171,3 m², në Shkodër, i cili rezulton të ketë një sipërfaqe më të madhe se dy apartamentet së bashku, për të cilat babai i subjektit kishte lidhur kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “{***}” ShPK.

16.4. Nga aktet e fashikullit të Komisionit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, lidhur me kalendarin e pagesave të kryera, për dy apartamentet e porositura te shoqëria “{***}” ShPK, ka deklaruar respektivisht:

(i) Në ILDKPKI, në procesverbalin e datës 15.1.2016, se: [...] *apartamenti me sip. 88 m² është blerë për llogari të vëllait F. L., me banim në Itali nga viti 1993 [...], ndërsa, në procesverbalin e datës 25.5.2021, ka deklaruar se: [...] apartamentet janë blerë në shumën 100.000 euro [...]. Në lidhje me vlerën e paguar, sqaroj se kemi paguar këstin e parë në shumën 19.000 euro, në vitin 2011 [...], me burim nga shitja e banesës në fshat, e cila është shitur në shumën 2.700.000 lekë. Shuma 2.600.000 lekë është paguar në bankë, në BKT, nga ana e blerësit në emrin tim dhe të babait tim [...], shuma e përfituar nga shitja e banesës në fshat dhe ajo e kredisë së marrë, pra rreth 6.100.000 lekë, kanë kaluar për blerjen e apartamenteve, që përbën pjesën time të detyrimit sipas marrëveshjes që kam me vëllain. Diferenca e shumës së mbetur pa shlyer, kemi rënë dakord që i takon vëllait ta mbyllë. Gjithsesi, marrëdhënia me firmën nuk është përfunduar, pasi objekti është i papërfunduar plotësisht, pa ashensor e parmakë, i paregjistruar, për këtë arsye edhe vlera e detyrimit do të zbritet.*

(ii) Në përgjigjet e dhëna për Komisionin, në përgjigje të pyetësorit nr. 1 të datës 20.9.2023²¹, subjekti i rivlerësimit deklaroi se, për blerjen e këtyre dy apartamenteve, janë kryer këto pagesa: (a) nëpërmjet transfertës bankare të datës 09.09.2011, në vlerën 2.107.500 lekë; (b) nëpërmjet depozitimit *cash* në datën 10.09.2012, në vlerën 500.000 lekë; (c) në datën 25.4.2013, është miratuar kredia në shumën 3.500.000 lekë, e marrë për blerjen e kësaj banese, e cila ka kaluar nga BKT-ja në llogarinë e shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK. Gjithashtu, në këtë pyetësor, subjekti ka deklaruar se nga vëllai i saj nuk është kryer asnjë pagesë tjetër ndaj shoqërisë “{***}” ShPK.

²⁰ Me shkresën nr. {***} prot., datë 19.10.2023.

²¹ Sipas të dhënave të “Kartelës së pasurisë së paluajtshme” të apartamentit me sip. 171,3, me nr. {***}, në zonën kadastrale {***}, Shkodër, të lëshuar më datës 01.12.2021, subjekti i rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani, rezulton bashkëpronarë me 1/3 pjesë takuese të kësaj pasurie.

16.5. Nga analizimi i deklarimeve dhe provave të administruara, rezulton se shuma totale e paguar për apartamentet me sip. 88 m² dhe 69 m², ka qenë 6.241.950 lekë (përafërsisht 44.500 euro), përkundrejt çmimit 113.000 euro të parashikuar në kontratën e porosisë. Pronësia mbi këtë pasuri – nga subjekti i rivlerësimit, vëllai dhe nëna e saj, si bashkëpronarë, është regjistruar mbi bazën e lejes së legalizimit nr. {***} datë 13.10.2021²², nga ASHK Shkodër, më datë 01.12.2021. Në këto kushte, rezulton se më datë 28.09.2023, kur subjekti i rivlerësimit ka kthyer përgjigjet për pyetësin nr. 1 të Komisionit, kjo pasuri ishte e regjistruar në regjistrat publikë dhe ajo rezultonte bashkëpronare e apartamentit me 1/3 pjesë.

16.6. Nisur nga deklaratimet e mësipërme, Komisioni ka verifikuar mundësinë e subjektit për të realizuar me burime të ligjshme pagesat e apartamentit në datat e deklaruara prej saj gjatë hetimit administrativ, duke kontrolluar për këtë shkak, krijimin e depozitës dyemërore të deklaruar si një prej burimeve të financimit. Nga analiza e kryer nga Komisioni, është evidentuar se nga këqyrja e lëvizjeve të llogarive të përcjella nga BKT-ja, konfirmohet se në llogarinë dyemërore të subjektit dhe të babait të saj, në datën 30.12.2004, është kryer depozitimi i shumës prej 2.100.000 lekësh, me përshkrimin: “Cash deposit”, si dhe një depozitim tjetër në datën 6.7.2005, me vlerë 500.000 lekë, me përshkrimin: “Françeskina Lekani, derdhje në depozitë 6-mujore”. Subjekti ka deklaruar në Komision, se këto shuma janë krijuar nga shitja e banesës në fshatin {***}, Shkodër, e cila ishte një objekt i paregjistruar. Lidhur me këtë rrethanë, rezulton se subjekti i rivlerësimit në DVP-2004, ka deklaruar te rubrika e “Pasurive të paluajtshme e të luajtshme”: *depozitë në bankën BKT, në shumën 2.100.000 lekë, më datë 24.12.2004, me burim nga shitja e shtëpisë, me pjesë takuese 100%*. Të njëjtin deklaram e ka bërë edhe te rubrika e “Të ardhurave”, në të cilën ka deklaruar shumën 2.100.000 lekë, me burim nga shitja e banesës në fshatin {***}, shumë e cila është arkëtuar në BKT Shkodër.

16.7. Në këto kushte, Komisioni ka analizuar nëse të ardhurat e siguruar nga shitja e banesës në fshatin {***}, provohet se janë krijuar në këtë mënyrë dhe nëse ato plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore, duke konkluduar se: *Komisioni çmon se marrëdhënia e shitblerjes e banesës në fshatin {***}, ndërmjet shtetasve F. L. dhe F. F., nuk është formalizuar në formën e kërkuar ligjore, për shkak se shitësi nuk e kishte të regjistruar banesën në regjistrin e pasurive të paluajtshme, megjithatë kjo rrethanë nuk përbën shkak që të arrihet në konkluzionin se marrëdhënia e shitblerjes në rastin konkret, nuk ekziston, për sa kohë që nga rrethanat e pasqyruara në paragrafin e mësipërm, rezulton se subjekti e ka deklaruar shitjen e banesës në DIPP/2004. Në vitin 2015, palët kanë bërë deklaratë të përbashkët për kalimin e kontratës së energjisë elektrike dhe marrëdhënia e shitblerjes konfirmohet nga shtetasi F. F., nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***}, datë 27.9.2023. [...] Nga analizimi i dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ndryshime deri në vitin 2004, në raport me faktet e mësipërme, në përfundim të rezultateve të hetimit, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti dhe babai i saj kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për depozitimin e vlerës 2.100.000 lekë, në datën 31.12.2004, në llogarinë dyemërore, pasi nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat e deklaruara si burim, dhe gjithashtu kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për depozitimin e vlerës 500.000 lekë, në datën 6.7.2004, në llogarinë dyemërore, pasi nuk provohet arkëtimi i kështit të dytë nga shitja e banesës në fshatin {***}, si dhe nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore për këto të ardhura.*

²² Të dhëna të sjella nga ASHK Shkodër me shkresën nr. {***} prot., datë 19.10.2023.

16.8. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ²³, me të cilat Komisioni i ka kaluar barrë prove për gjetjet e mësipërme, ka shpjeguar se: **(i)** shitja e banesës në fshatin {***}, nuk është kryer me akt noterial, pasi kjo banesë nuk ka qenë e regjistruar në kadastër dhe paratë e shitjes babai i saj i ka depozituar në llogarinë e përbashkët në BKT; **(ii)** lidhur me faktin se nga babai i saj nuk janë paguar detyrimet tatimore, subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e dhëna për rezultatet e hetimit administrativ, ka deklaruar se: *Lidhur me faktin se nga babai im nuk janë paguar detyrimet tatimore, nuk kam pasur dijeni deri tani. Gjithsesi, kjo nuk mund të shpjerë në konkluzionin se këto të ardhura, të provuara me prova shkresore që kanë ekzistuar realisht, të njohura nga ana juaj se marrëdhënia ka ekzistuar dhe shitja është kryer siç pretendohet nga unë, nuk ekzistojnë dhe nuk duhen marrë në konsideratë. Aktualisht, sot, si trashëgimtare ligjore e babait tim, bashkë me trashëgimtarët e tjerë, marr përsipër pagimin e këtij detyrimi ndaj shtetit.* Pavarësisht këtij shpjegimi, rezulton se, as me ankimin, subjekti nuk ka paraqitur ndonjë të dhënë lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore për vlerën e përfituar nga shitja e apartamentit në fshatin {***}, dhe as deklaronte/shpjegonte për mënyrën si pretendon të realizojë/shlyejë këto detyrime.

16.9. Për t'u dhënë përgjigje pretendimeve të subjektit rreth ligjshmërisë të shumës prej 2.600.000 lekësh, të pretenduar prej saj se ka derivuar nga shitja e banesës në fshatin {***}, të cilat nuk janë njohur nga Komisioni si burim për krijimin e depozitës dyemërore në emër të saj dhe babait, e të përdorur më pas për financimin e apartamentit objekt kontrolli, trupi gjykues mori në shqyrtim aktet e administruara në Komision nga korrespondenca me ASHK-në, lidhur me këtë banesë, të cilat japin informacionin si vijon:

(i) Me aplikimin nr. {***} prot., datë 25.09.2018, me nr. id. {***}, në emër të F. F. L. (babai i subjektit të rivlerësimit), është bërë kërkesë për legalizim objekti, me adresë në fshatin {***}, në zbatim të VKM-së nr. 441, datë 18.07.2016, "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë e të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, dhe të truallit funksional të tyre.

(ii) Më parë, me "Kërkesën" e datës 28.01.2015, drejtuar Komunës {***}, Shkodër, e nënshkruar nga F. F. L., ky shtetas ka kërkuar regjistrimin e banesës së tij me nr. {***}, në zonën kadastrale 1965, në fshatin {***}, bashkëlidhur së cilës gjendet edhe plani i rilevimit të pasurisë, e cila identifikohet me pronar F. L.

(iii) Pas kësaj kërkesë, me anë të shkresës me nr. {***} prot., datë 11.03.2015, të ALUIZNI-t Shkodër, e cila i dërgohet Komunës {***}, sqarohet se, pas verifikimeve të bëra, rezulton se në

²³ Në rezultatet e hetimit administrativ, faqe 26, Komisioni konstaton se:

"6.69 Shkronja "g" e pikës 1 e nenit 8 të ligjit të sipërcituar, parashikon se, për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë.

6.70 Gjithashtu, të ardhurat e realizuara nga kalimi/transferimi i të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme të paregjistruara në regjistrat publikë, nuk bën pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga tatimi, referuar nenit 8/1 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

6.71 Sa më lart, babai i subjektit ka pasur detyrimin për të deklaruar dhe paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e realizuara nga transaksioni i shitjes, çka nuk është provuar deri në këtë fazë të hetimit.

6.72 Për rrjedhojë, të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës në fshatin {***}, nuk i plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës e, për këtë arsye, nuk konsiderohen të ardhura të ligjshme".

pasurinë me nr. {***}. ZK. {***}, fshati {***}, Shkodër, ka vetëdeklarim për objekt në proces legalizimi nr. {***} prot., datë 15.11.2006, në posedim të shtetasit A. U.²⁴.

16.10. Në analizë të të dhënave të renditura më sipër, trupi gjykues konstaton gjithashtu se:

(i) Në vitin 2015, pra, pasi subjekti ka deklaruar në DVP-2004, se është shitur banesa në fshatin {***}, babai i saj kërkon të legalizojë banesën e ndërtuar para vitit 1991. Në një ecure normale të procedurave, do të duhej që babai i subjektit të deklaronte pranë ALUIZNI-t, se ai e ka shitur këtë objekt, duke deklaruar edhe vlerën përkatëse dhe, për pasojë, si aplikant për legalizim të figuronte blerësi i kësaj prone. Në këto rrethana, mbetet e pakuptimtë përse babai i subjektit ka kërkuar të regjistrohet si pronar i banesës në fshatin {***}, një objekt tashmë i shitur prej tij, dhe nuk referon para institucionit së legalizimit të pronave se ai nuk e posedon më këtë pasuri, duke kërkuar që procesi i legalizimit të vijojë me blerësin.

(ii) Nga ana tjetër, nga praktika e mësipërme, evidentohet se për banesën në fshatin {***}, për legalizimin e saj si posedues i këtij objekti, ka bërë vetëdeklarim për legalizim me nr. {***}, datë 15.11.2006, edhe shtetasi A. H. U., i cili është i ndryshëm nga ai i deklaruar prej subjektit të rivlerësimit si blerës i banesës në vitin 2004. Rezulton se, për të provuar shitjen e banesës në fshatin {***}, subjekti i rivlerësimit, së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*, ka paraqitur në ILDKPKI një deklaratë me shkrim dore, të hartuar nga z. F. F., i cili deklarohet si blerës i këtij objekti për shumën 2.700.000 lekë (ndërkohë subjekti në DVP-2004, ka deklaruar shitjen për shumën 2.100.000 lekë).

(iii) Me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 01.11.2023, ASHK Shkodër i ka përcjellë Komisionit kërkesën e shtetasit F. F. për legalizim të banesës në fshatin {***}, dhe praktikën bashkëlidhur, kërkesë e cila mban nr. {***} prot., datë 06.06.2017, në të cilën deklarohet se banesën e ka blerë para disa vitesh, dhe se ajo është ndërtuar para vitit 1990.

(iv) Nga sa më sipër referuar, konstatohet se situata bëhet edhe më e paqartë, kur në praktikën e përcjellë në Komision nga ASHK Shkodër, me nr. {***} prot., datë 25.07.2023, gjendet edhe aplikimi me nr. {***} prot., me Id {***}, i datës 25.09.2018, i bërë nga F. F. L., me të cilin kërkon kalimin e pronësisë së objektit të ngritur para vitit 1991 në fshatin {***}, ndërsa rezulton se babai i subjektit, z. F. F. L., ka ndërruar jetë më datë 01.08.2016 dhe, për të, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 26.09.2016. Në këtë praktikë, po ashtu gjendet edhe një kërkesë e datës 28.01.2015, e nënshkruar nga babai i subjektit, i cili i kërkon Komunës {***}, Shkodër, të regjistrojë shtëpinë e tij të banimit në fshatin {***}, me vendndodhje në parcelën {***}, në zonën kadastrale {***}, banesë e cila është ndërtuar para vitit 1990.

(v) Në përgjigjet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, si dhe në ankim, ajo identifikon si blerës të objektit në fshatin {***}, vetëm z. F. F., i cili po ashtu ka konfirmuar blerjen e banesës edhe me deklaratën noteriale të datës 27.09.2023.

16.11. Në konsideratë të sa evidentuar më sipër, trupi gjykues konstaton se qëndrimi i babait të subjektit, si dhe sjellja e trashëgimtarëve pas vdekjes së tij tregojnë se në asnjë moment, ata nuk kanë deklaruar para institucioneve kompetente si ALUIZNI, shitjen e kësaj prone, e cila, siç pretendon subjekti, ka ndodhur në vitin 2004, pra para se të niste procesi i legalizimit me ligjin nr. 9484, datë 03.04.2006, i ndryshuar. Në këtë kushte, plotësimi i aplikimeve për legalizimin e banesës në fshatin {***}, si ndërtim informal, tregon interesin për regjistrimin e kësaj prone në emër të babait të

²⁴ Fakt të cilin Komisioni ia ka bërë të ditur subjektit me pyetjet e pyetësorit nr. 1, situatë për të cilën subjekti nuk ka dhënë shpjegime.

subjektit, situatë e cila rezulton të mos jetë shëruar edhe pas vdekjes së babait, në gusht 2016, pasi sërish trashëgimtarët e tij kanë aplikuar pranë AShK Shkodër, për legalizim të banesës në emër të tij. Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim në hetim, por as në ankim, përse aplikimi tek ALUIZMI, për legalizimin e këtij objekti, figuron në emër të z. A. U., si dhe nuk ka dhënë asnjë shpjegim se si, nëpërmjet procesit të legalizimit, do të shërojë çështjen e pagimit të detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara, në vlerën 2,7 milionë lekë, si të përfituara nga shitja e banesës z. F. F., i cili po ashtu në vitin 2017, ka aplikuar për legalizimin e së njëjtës banesë në emër të tij.

16.12. Në vlerësimin e trupit gjykues, të dhënat e siguruara nga organet shtetërore të referuara më sipër, evidentojnë se qëndrimet dhe sjelljet e babait të subjektit dhe saj ndër vite, në raport me banesën në {***}, Shkodër, së paku tregojnë se prej tyre nuk janë kryer veprime që kanë pasur në fokus shlyerjen e detyrimeve tatimore, lidhur me të ardhurën e siguruar nga shitja e këtij objekti në vitin 2004. Situata e përshkruar më sipër, evidenton ndërmarrjen e veprimeve administrative në vitet 2015 dhe 2018, me të cilat synohet që babai i subjektit të regjistrohet si pronar i kësaj banese, qëndrime të cilat janë në kontradiktë me pretendimin për shitjen e këtij objekti dhe sigurimin e një të ardhure të konsiderueshme.

16.13. Të dhënat e analizuara më sipër, duket se ngrenë dyshime domethënëse për shitjen e banesës në termat e pretenduar prej subjektit, konsideruar edhe mungesën krejtësisht të elementeve të formës së këtij transaksioni, si regjistrimi i pasurisë apo hartimi i një dokumenti që përmban disa elemente që sigurojnë vullnetin e palëve apo provojnë ekzistencën e tij për kalimin e të drejtave, si edhe çmimin/vlerën korresponduese në këmbim. Pavarësisht këtij konstatimi, në kushtet kur Komisioni në vendim ka mbajtur qëndrimin se: *mungesa e formalizimit të shitjes së banesës në një akt që ka formën e kërkuar ligjore [...] nuk përbën shkak për të, se marrëdhënia e shitblerjes në rastin konkret nuk ekziston*²⁵, në zbatim të parimit “*no reformatio in peius*”, trupi gjykues nuk mund të ekstraktojë nga kjo problematikë çështje që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi, por analiza e mësipërme vlen për të vlerësuar konkluzionin e Komisionit rreth ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, në kuadër të detyrimeve që burojnë nga barra e provës që subjektet e rivlerësimit kanë në këtë proces, për të provuar të gjitha deklaratimet apo pretendimet e tyre.

16.14. Në të tilla kushte, si elemente që mund të vinin në diskutim konkluzionin e Komisionit se *ka mbetur e paprovuar pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën 2,7 milionë lekë, të deklaruar nga subjekti si të përfituar nga shitja e banesës në fshat*, mund të ishte së paku fakti se babai i subjektit apo ajo më pas, me cilësinë e trashëgimtares, të ishte kujdesur të deklaronte tek ALUIZMI shitjen e këtij objekti që në vitin 2004, pra para se procesi i legalizimit të niste me miratimin e ligjit nr. 8492, të datës 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, për të demonstruar vullnetin se, në momentin që kjo pasuri legalizohej e regjistrohej në mënyrën e duhur në regjistrat publikë, formalizimi i transaksionit të shitjes së ndodhur më parë, do të kryhej

²⁵ Në paragrafin 6.40, Komisioni mban qëndrimin se: “Nga analizimi i fakteve të mësipërme, Komisioni çmon se marrëdhënia e shitblerjes së banesës në fshatin {***}, ndërmjet shtetasve F. L. dhe F. F., nuk është formalizuar në formën e kërkuar ligjore, për shkak se shitësi nuk e kishte të regjistruar banesën në regjistrin e pasurive të paluajtshme, megjithatë kjo rrethanë nuk përbën shkak që të arrihet në konkluzionin se marrëdhënia e shitblerjes në rastin konkret, nuk ekziston, për sa kohë që nga rrethanat e pasqyruara në paragrafin e mësipërm, rezulton se subjekti e ka deklaruar shitjen e banesës në DIPP/2004. Në vitin 2015, palët kanë bërë deklaratë të përbashkët për kalimin e kontratës së energjisë elektrike dhe marrëdhënia e shitblerjes konfirmohet nga shtetasi F. F. nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***}, datë 27.9.2023”.

edhe përmes ASHK-së, si agjent i tatimor i detyrimeve që burojnë nga këto transaksione. Një sjellje e tillë do të provonte së paku mirëbesimin dhe qasjen për të shlyer në raport me shtetin, detyrimet monetare që vinin nga një veprim i tillë juridik, i cili mund të afektonte këtë proces nëpërmjet një vlerësimi objektiv të rrethanave e një qëndrimi garantist rreth ligjshmërisë së të ardhurave në shumën prej 2.700.000 lekësh. Për pasojë, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se kjo e ardhur nuk plotëson standardet e së ardhurës së ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

16.15. Trupi gjykues, në vijim të analizës për pagesat e kryera për apartamentin në Shkodër me sip. 171 m², përveç sa më sipër analizuar lidhur me ligjshmërinë e krejt shumës prej 2.700.000 lekësh, të pretenduar se vjen nga shitja e banesës në fshatin {***}, u ndal edhe në verifikimin e mundësisë së subjektit për të realizuar me burime të ligjshme pagesën e kështit të dytë të këtij apartamenti, në shumën 600.000 lekë, pagesë të cilën subjekti ka pretenduar se e ka realizuar me fondet e depozitës në BKT, në vitin 2005, në shumën 500.000 lekë, në kontekstin e verifikimit të deklarimeve dhe provueshmërisë së krijimit të saj.

16.16. Referuar pagesave në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, për blerjen e apartamentit, respektivisht kështit të parë me vlerë 2.107.500 lekë (ekuivalent me 15.000 euro), paguar më datë 9.9.2011, si dhe kështit të dytë me vlerë 5.000 euro (ekuivalent me 690.000 lekë), paguar më datë 10.9.2012, subjekti i rivlerësimit pretendon se ato janë kryer me të ardhurat e siguruara nga shitja e banesës së babait në fshatin {***}, Njësia Administrative {***}, në shumën totale prej 2.700.000 lekësh.

Nga shqyrtimi i DVP-së, rezulton se subjekti fillimisht ka deklaruar shitjen e këtij objekti në DVP-në e vitit 2004, në shumën 2.100.000 lekë, por pa specifikuar që kjo shumë përbënte vetëm kështin e parë të pagesës dhe se pjesa e mbetur e pashlyer, ishte në masën 600.000 lekë. Në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar që shumën e përfituar nga shitja e banesës, e ka depozituar në BKT, fakt i cili konfirmohet dhe nga *statement*-i i lëshuar nga banka, ku rezulton se më datë 30.12.2004, në emër të F. L., është depozituar, me përshkrimin “*cash depozit*”, shuma e sipërcituar.

16.17. Lidhur me pagesën e kështit të dytë, prej 600.000 lekësh, të pretenduar nga subjekti si të shlyer nga blerësi (babai) në vitin 2005, *së pari*, konstatohet se mungon deklarimi nga subjekti i rivlerësimit në DVP-2004 që pasuria të jetë shitur në vlerën prej 2.100.000 lekësh dhe 600.000 lekësh, ndërsa deklarohet vetëm shuma e parë, si edhe mungon deklarimi në DVP-2005, në momentin e marrjes nga blerësi, i shumës (600.000 lekë) së pretenduar si pjesë e çmimit të shitjes. *Së dyti*, rezulton se dhe në deklaratën *vetting*, mungon deklarimi i vlerës së plotë të përfituar nga shitja e pasurisë në fshatin {***}, të pretenduar nga subjekti në shumën totale prej 2.700.000 lekësh. Momenti²⁶ kur subjekti ka deklaruar këtë vlerë si të krijuar nga shitja e banesës në fshat, është me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, të përcjella në Komision me *e-mail*-in e datës 28.09.2023, deklarim i cili ka mbetur në nivelin deklarativ dhe i pambështetur në ndonjë akt tjetër shkresor. Këtij qëndrimi i bashkëlidhet arsyetimi i mësipërm rreth ligjshmërisë së të ardhurave nga shitja, të cilat vlejné për të konfirmuar konkluzionin e Komisionit, se edhe kjo shumë nuk mund të konsiderohet se është krijuar me burime të ligjshme, e të konsiderohet si e ardhur për financimin e apartamentit në analizën financiare që kryhet për të verifikuar burimet e krijimit të tij.

²⁶ Në procesverbalin pranë ILDKPKI-së, në vitin 2016, subjekti ka deklaruar se kështi i dytë, prej 500.000 lekësh, është burimi i depozitimit në BKT në datën 6.7.2005, ndërsa në procesverbalin e vitit 2021, ka deklaruar që kështi prej 600.000 lekësh është paguar nga blerësi në vitin 2012, mospërputhje për të cilën subjekti, në pyetësorin nr. 1, ka sqaruar se koha e saktë i përket datës 06.07.2005, kur këto para janë depozituar në bankë në vitin 2005.

16.18. Në të tilla kushte, trupi gjykues, lidhur me depozitimet e kryera në llogarinë dyemërore në BKT, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe babai i saj kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 2.600.000 lekë, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vlerëson se, në analizë të të gjitha rrethanave që kanë dalë nga hetimi administrativ, veçanërisht të atyre që kanë rezultuar lidhur me procesin e legalizimit të pasurisë së ndodhur në fshatin {***} në Shkodër, duke abstraguat problematikën dhe dyshimet që ekzistojnë lidhur me vetë transaksionin e shitjes së saj, për shkak të qëndrimit konfirmues të mbajtur prej Komisionit, demonstron qartësisht jo vetëm mungesa e pagimit të detyrimeve tatimore, siç ka konkluduar Komisioni, por edhe mospasja e asnjë vullneti/qëllimi për ta kryer atë edhe në vijim, në funksion të shërimit të paligjshmërinë së këtyre të ardhurave, në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

16.19. Në vijim, trupi gjykues u ndal në analizimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani, me të cilat ajo kundërshton si të padrejtë dhe jo të bazuar në prova konkluzionin e Komisionit se *për apartamentet me sip. 88 m² dhe sip. 69 m² (të cilat, pas bashkimit, kanë formuar apartamentin me sip. 171 m²), ajo është përpjekur të fshehtë nga kontrolli apo verifikimi marrëdhënien e plotë të pronësisë mbi këto pasuri e, për pasojë, edhe burimet e krijimit të tyre, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, duke analizuar sa vijon.*

16.20. Trupi gjykues, nga kontrolli i ushtruar për këtë shkak ankimi, konstaton se subjekti i rivlerësimit, për këtë pasuri, me ankimin, nuk ka paraqitur të dhëna apo shpjegime shtesë të ndryshme nga ato të paraqitura në Komision, nga shqyrtimi i të cilave konstatohen rrethanat si vijojnë.

Së pari, rezulton se apartamenti me sip. 171 m², origjinën e tij e ka nga kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 7.9.2011, në të cilën porositës është babai i subjektit F. L., i cili ka porositur te shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK, dy apartamente banimi me sip. 88 m² dhe 69 m², të dy me pozicionim në katin e dytë teknik të objektit, për çmimin e dakordësuar në total për të dy apartamentet, në shumën 103.000 euro, në rast se të gjitha punimet e brendshme do të realizohen nga porositësi dhe në shumën 113.000 euro, në rast se të gjitha punimet e brendshme do të kryhen nga shoqëria sipërmarrëse “{***}” ShPK.

Së dyti, nga praktika e administruar gjatë hetimit administrativ nga ASHK Shkodër, me shkresën nr. {***} port., datë 19.10.2023, informohet se, me vendimin nr. {***}, datë 13.10.2021, të ALUIZNI-t, është nxjerrë leje për legalizimin e objektit pa leje, të llojit “objekt me shkelje të lejes së ndërtimit”, të poseduar nga F. L., me sipërfaqe ndërtimi 171,3 m², me përshkrimin “njësi banimi” në katin e dytë në një “godinë banimi dhe shërbimi 3kt + nënçati të shfrytëzuar”, në thyerje të lejes së ndërtimit. Mbi bazën e këtij vendimi për legalizimin e objektit pa leje, të kontratës noteriale të sipërmarrjes nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 7.9.2011, si dhe në zbatim të dëshmisë së trashëgimisë ligjore (çështje e trajtuar më sipër), subjekti i rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani, së bashku me vëllain F. L. dhe nënën G. L., sipas “Certifikatës së regjistrimit të pronësisë”, me kod unik {***}, që prej të datës 01.12.2021, figurojnë bashkëpronarë me 1/3 pjesë takuese të apartamentit me sip. 171,3 m², në zonën kadastrale nr. {***}, Shkodër. Nga sa më sipër, rezulton se subjekti dhe familjarët e saj, mbi bazën e një leje legalizimi, kanë fituar pronësinë mbi një apartament të vetëm, i cili, në sipërfaqe, rezulton të jetë më i madh se 2 apartamentet për të cilat ishte lidhur kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “{***}” ShPK.

Së treti, nga analizimi i deklarimeve të subjektit, si dhe provave të administruara, duket se shuma totale e paguar për apartamentin, në momentin kur ka dalë leja e legalizimit, ka qenë 6.241.950 lekë (rreth 44.500 euro), përkundërt çmimit prej 113.000 eurosh, të parashikuar në kontratën e porosisë. Po ashtu, rezulton se mbi këtë pasuri, nga AShK Shkodër, më datë 01.12.2021, subjekti, vëllai dhe nëna e saj janë regjistruar si bashkëpronarë, pa pasur asnjë konfirmim për shlyerjen e detyrimit të mbetur nga çmimi i dakordësuar të shoqëria e ndërtimit “{***}” ShPK, në zbatim të kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 7.9.2011.

Së katërti, në referim të kontrollit të analizës së bërë në Komision për mundësinë e justifikimit me burime të ligjshme të pagesave për krijimin e kësaj pasurie, u konfirmua pamundësia financiare për të disponuar të ardhura të ligjshme si nga babai, ashtu edhe nga vëllai i subjektit, të cilin ajo e deklaroi si bashkëfinancues të kësaj pasurie, edhe për shumën që rezulton se është paguar efektivisht, në vlerën prej 6.241.950 lekësh, nga 113.000 euro që ishte vlera e dakordësuar si çmim, pa konsideruar këtu problemet që lidhen me mungesën e pagesës së pjesës tjetër të çmimit, që përfaqëson pothuaj $\frac{1}{2}$ e vlerës së tij, situatë që merr kuptim dhe shpjegohet në kontekstin e analizës në vijim, lidhur me konfliktin e interesit.

Së pesti, rezulton se në apartamentin e vetëm të krijuar nga bashkimi i dy apartamenteve të porositura, banon dhe përdoret vetëm prej subjektit të rivlerësimit, gjithashtu nuk ekzistojnë të dhëna që tregojnë se në këtë apartament ka banuar apo banon edhe vëllai i subjektit, i cili rezulton të jetë rezident në shtetin italian, por pretendohet se është financuesi potencial i $\frac{1}{2}$ së vlerës së çmimit. Trupi gjykues vlerëson, ashtu si edhe Komisioni, se krijohet një bazë faktike e mjaftueshme që krijon bindjen se ky apartament është pasuri vetëm e subjektit të rivlerësimit.

16.21. Në vijim dhe brenda kontekstit të kësaj analize, trupi gjykues vlerësoi të shqyrtojë edhe problematikat e evidentuara nga Komisioni në rubrikën “Konstatime të tjera”, të cilat i referohen ndjekjes nga subjekti i rivlerësimit të procedimit penal nr. {***}/2022, të kualifikuara se e kanë vendosur subjektin në situatën e konfliktit të interesit dhe të kontestuara prej subjektit në ankim, për të cilat analizon sa vijon.

16.22. Komisioni, pasi ka analizuar disa rrethana që lidhen me një procedim penal të trajtuar nga subjekti i rivlerësimit ndaj shtetasit A. D., ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit, për shkak se, me këtë shtetas, ajo kishte hyrë në një marrëdhënie kontraktore për porositjen e apartamentit të banimit me sip. 171 m². Komisioni ka analizuar edhe pretendimet e saj se kontrata e porosisë nuk është lidhur me shtetasin Sh. D., por me djalin e tij A. D., duke arsyetuar mbi faktin se i ndjekuri prej subjektit është ortak i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK, mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë²⁷ mbi rolin dhe tagrat e përfaqësuesit, duke potencuar se:

*Në pjesën hyrëse të kontratës së sipërmarrjes nr. {***}, datë 7.9.2011, ku parashikohen palët në kontratë, pasqyrohet në cilësinë e palës “sipërmarrës/investitor”, shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK, e përfaqësuar nga shtetasi Sh. D. D. dhe e përfaqësuar me prokurë nga shtetasi A. Sh. D., prokurë e përgjithshme nr. {***}, datë 6.8.2010, dhe në cilësinë e palës “porositës” pasqyrohet shtetasi F. L. Në fund të kontratës pasqyrohen nënshkrimet e palëve, ku në cilësinë e palës “sipërmarrës/investitor” figuron shoqëria “{***}” ShPK, me përshkrimin “Përfaqësuar me prokurë të përgjithshme”, si dhe nënshkrimi i shtetasit A. D.*

²⁷ Vendimi nr. {***}, datë 05.11.2015, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Referuar fakteve të mësipërme, është e qartë se shtetasi A. D., me firmosjen e kontratës së sipërmarrjes, ka vepruar në emrin dhe për llogari të shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, e cila mbart të drejtat dhe detyrimet. Për pasojë, kontrata konsiderohet e lidhur ndërmjet babait të subjektit të rivlerësimit/ F. L. dhe shoqërisë “{***}” ShPK.

[...] Si pasojë, në rastin e kontratës së sipërmarrjes së vitit 2011, është bërë suksedimi (zëvendësimi) i palës porositëse nga shtetasi F. L. te trashëgimtarët e tij, të cilët mbartin të drejtat dhe detyrimet e kontratës në përpjesëtim me pjesën e tyre. Në këtë kuptim, subjekti i rivlerësimit ka trashëguar jo vetëm të drejtën e pronësisë, por edhe detyrimet e babait të saj ndaj shoqërisë ndërtuese, në përpjesëtim me pjesën që ka trashëguar nga pasuria.

Sa i përket shpjegimit të subjektit të rivlerësimit, se nga ana e saj ka qenë e shlyer plotësisht pjesa takuese e detyrimit dhe në vitet në vijim ka mbetur pa shlyer vetëm detyrimi i vëllait, ky shpjegim mbetet në nivel deklarativ, pasi, referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe deklarimeve të saj në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk rezulton që pasuritë apartament të jenë pjesëtuar (ndarë) ndërmjet trashëgimtarëve ligjorë të F. L., përkundrazi rezulton që të dyja apartamentet e porositura nga ana e tij, janë bashkuar në një apartament të vetëm, ku jeton subjekti i rivlerësimit bashkë me nënën e saj dhe ky apartament është regjistruar në regjistrat publikë në bashkëpronësi me 1/3 pjesë të secilit prej tyre. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit bashkë me nënën dhe vëllain e saj janë të detyruar në mënyrë solidare t’i paguajnë shoqërisë “{***}” ShPK, shumën e mbetur nga çmimi i shitjes.

Në përfundim, lidhur me konfliktin e interesit, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në ndjekjen dhe marrjen e vendimit për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2022, gjendet në situatën e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.

16.23. Trupi gjykues, lidhur me sa është evidentuar më sipër, vëren se nga hetimi administrativ kryesisht i Komisionit, kanë rezultuar disa fakte të cilat janë analizuar në funksion të kualifikimit të situatës si një gjendje e konfliktit të interesit, si vijojnë: **(i)** ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe babait të subjektit të rivlerësimit, z. F. L., është lidhur kontrata e sipërmarrjes e datës 07.09.2011, për porositjen e dy apartamenteve në vlerën 113.000 euro; **(ii)** shuma që i është paguar shoqërisë për këtë apartament nga subjekti dhe babai i saj, është në vlerën 6.241.950 lekë; **(iii)** pas vdekjes së shtetasit F. L., subjekti rezulton trashëgimtare ligjore e tij, duke gëzuar 1/3 e pjesës së pasurisë apartament; **(iv)** subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar që marrëdhënia me shoqërinë nuk është përfunduar²⁸, ndonëse mbetet e paqartë si ka vijuar ecuria e saj, për sa kohë, sipas të dhënave të kartelës së pasurisë së paluajtshme lidhur me këtë pasuri, të lëshuar nga ASHK-ja më datë 01.12.2021, subjekti i rivlerësimit rezulton bashkëpronare me 1/3 pjesë takuese të kësaj pasurie, që do të thotë se shoqëria i ka kaluar të drejtat e pronësisë mbi këtë pasuri, ndonëse çmimi nuk është paguar në ½ vlerë të tij.

16.24. Nga ana tjetër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. {***}/2022, të regjistruar më datë 13.01.2022, mbi bazën e kallëzimit të Zyrës së Përmbarrimit Shkodër, për shtetasin Sh. D. D., për veprën penale “Pengime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore”, parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal. Më pas, me vendimin e datës 30.6.2022, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {***}/2022, sipas kritereve ligjore të parashikuara nga neni 328/b i Kodit të Procedurës Penale.

²⁸ Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI më datë 25.05.2021.

16.25. Për shkak të situatave të mësipërme, Komisioni ka konkluduar se subjekti gjendet në kushtet e konfliktit të interesit në trajtimin e çështjes penale të sipërcituar, meqenëse ajo kishte një marrëdhënie juridike civile me shtetasin të cilit i atribuohet vepra penale. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni, në mënyrë abuzive dhe tërësisht të njëanshme, ka arritur në përfundimin për cenimin e besimit të publikut, duke u mbështetur vetëm në një rast të vetëm. Sipas subjektit, nga thelbi i rezultateve të hetimit lidhur me këtë rast, nuk rezulton asnjë shkelje ligjore në mënyrën e zgjidhjes së çështjes konkrete. Po ashtu, subjekti thekson se qëndrimi i Komisionit për cenimin e besimit të publikut, është bazuar ekskluzivisht në një situatë të vetme, të pretenduar, konflikti i interesit, për të cilën duhet të kishte dhënë dorëheqjen. Në këtë kuadër, subjekti vlerëson se, duke zbatuar parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, një rrethanë e tillë e izoluar nuk mund dhe nuk duhet të shërbejë si shkak për masën disiplinore të shkarkimit.

16.26. Nisur nga këto qëndrime të subjektit, konstatohet, *së pari*, se, prej saj nuk kundërshtohen dhe as nuk jepen argumente në thelb kundër konkluzionit të Komisionit se, në ndjekjen e procedimit penal nr. {***}/2022, ndaj shtetasit Sh. D. (njëkohësisht edhe ortak i vetëm²⁹ i shoqërisë së ndërtimit me të cilën subjekti dhe bashkëpronarët e tjerë kishin ende një marrëdhënie kontraktuale të pambyllur) ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit. Në këtë kontekst, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, çmon se për sa kohë subjekti i rivlerësimit, ndaj z. Sh. D., ka pasur interesa privatë/detyrime ende të pashlyera për shkak të mospagimit të çmimit të plotë të apartamentit, ajo duhet të kishte reaguar ndaj situatës në referim të parashikimeve ligjore që rregullojnë shmangien nga konflikti i interesit të funksionarëve publikë³⁰ dhe të jepte dorëheqjen nga ndjekja e këtij procedimi penal. Fakti që në kohën kur është ushtruar ky procedim penal, subjekti i rivlerësimit, si trashëgimtare ligjore e babait të saj, kishte ende detyrime të pashlyera ndaj shoqërisë në pronësi të personit ndaj të cilit zhvilloheshin hetimet, detyrime për të cilat deri në gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, nuk ka të dhëna se janë shlyer ende, përcaktonte zbatimin e nenit 17, pika 1, shkronja “a” e Kodit të Procedurës Penale, i parë në harmoni me nenin 26 të këtij Kodi.

16.27. Fakti që subjekti, megjithëse kishte detyrim të shmangte konfliktin sipas kësaj dispozite, ka vijuar të ushtrojë funksionet e saj zyrtare, duke vendosur pushimin e procedimit penal ndaj shtetasit Sh. D., i parë në harmoni me mospagimin e detyrimit të vlerës prej 68.500 eurosh³¹, nëse si çmim i shitjes pranohet vlera prej 113.000 eurosh; dhe në shumën 58.500 euro³², nëse si çmim i shitjes së apartamenteve pranohet vlera 103.000 euro, ndërsa pronësia mbi këtë pasuri ka kaluar pavarësisht mospagimit të plotë të çmimit, e vendos subjektin në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, sepse rezulton se ajo ka fituar pasurinë objekt analize në kushtet e

²⁹ Sipas të dhënave të siguruara nga burime të hapura, të marra nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) për shoqërinë “{***}” ShPK, me NIPT {***}, rezulton se në periudhën nga 24.05.2001 deri më 21.03.2018, si ortak i vetëm dhe administrator i kësaj shoqërie ka qenë z. Sh. D.

³⁰ Në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në nenin 1 të tij përcaktohet se: ““Konflikti i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike”.

³¹ Kjo vlerë është përllogaritur nëse si çmim i shitjes së dy apartamenteve me sip. 88 m² dhe 69 m² është marrë vlera 113.000 euro (me punime të përfunduara), duke zbritur shumën 44.500 euro, që përfaqëson vlerën e konvertuar të pagesave të realizuara për këtë pasuri.

³² Kjo vlerë është përllogaritur nëse si çmim i shitjes së dy apartamenteve me sip. 88 m² dhe 69 m² është marrë vlera 103.000 euro (me punime të papërfunduara), duke zbritur shumën 44.500 euro, që përfaqëson vlerën e konvertuar të pagesave të realizuara për këtë pasuri.

një konflikti me ushtrimin e detyrës. Konkluzioni i mësipërm vlen të konsiderohet edhe nën dritën e analizës së të drejtave të pronësisë së subjektit mbi këtë pasuri. Sipas kësaj linje arsyetimi, subjekti, si i vetmi bashkëpronar që mund të kishte një trajtim të tillë të privilegjuar në raport me shoqërinë e ndërtimit, dhe të drejtat e fituara në mënyrë dominuese mbi këtë predispozitë, potencojnë, krahas argumenteve të analizuara më lart, konkluzionin se e gjithë pasuria në fjalë është pasuri *de facto* e subjektit.

16.28. Në referim të sa analizuar më sipër, lidhur me pasuritë, dy apartamente banimi me sipërfaqe totale 171 m², në vlerën 113.000 euro, të ndodhura në Shkodër e të deklaruar prej subjektit të rivlerësimit si në bashkëpronësi, me pjesë takuese prej 1/3 në deklaratën e pasurisë *vetting*, trupi gjykues arriti në konkluzionin se është i drejtë vlerësimi i Komisionit se subjekti është përpjekur të fshehë marrëdhënien e vërtetë të saj me këtë pasuri, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

16.29. Në arritjen e këtij konkluzioni, u mbajtën në konsideratë një sërë elementesh të parashtruara edhe prej Komisionit, si: **(i)** fakti që subjekti e zotëron dhe e përdor pasurinë si pronare e saj pa shlyer gati 50% të çmimit të shitjes, në mënyrë të pashpjegueshme; **(ii)** fakti që subjekti rezulton në mungesë të burimeve të ligjshme edhe për pagimin e kështit të parë e të dytë, në vitet 2011 e 2012, si dhe mosdeklarimi i kësaj pasurie në DPV-në e vitit 2013, kur ajo ka marrë kredi për të financuar krijimin e saj, duke deklaruar në këtë DPV vetëm kredinë, por asnjë të dhënë për shtëpinë ku ajo do të përdorej; **(iii)** paprovueshmëria e kontributit të vëllait të saj si bashkëfinancues i deklaruar i pasurisë, ndërkohë që ai rezulton sërish me pamundësi të përballimit të shpenzimeve të jetesës në Itali dhe duket krejtësisht i paarsyeshëm investimi tej mundësive të tij në pasuri, të cilat ai nuk rezulton se i gëzon apo se i përdor; **(iv)** situata e konfliktit të interesit, në të cilën subjekti është gjendur për shkak të hetimit të një procedimi penal në vitin 2022 ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, e cila është shoqëria ndërtuese e objektit ku ndodhet ky apartament, ndërsa ekzistonte ende, sipas deklarimeve të vetë subjektit, detyrimi i pashlyer prej saj te kjo shoqëri, edhe si bashkëpronare formale, e gati 50% të vlerës së kësaj pasurie, e cila kualifikohet sipas nenit 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016; **(v)** fakti që të paktën deri në dhënien e vendimit nga Komisioni, nuk rezulton të jetë bërë asnjë përpjekje nga subjekti apo vëllai i saj për të shlyer detyrimet ndaj shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK, sjellje që e vendosin atë në një marrëdhënie të pashpjegueshme në raport me këtë pasuri dhe të palogjikshme në këndvështrim të rregullave të tregut; **(vi)** mungesa e plotë e ndonjë prove që tregon për kontribut apo investim të vëllait të subjektit në krijimin e kësaj pasurie, si edhe regjistrimi në regjistrat publikë të saj, në shmangie të shlyerjes formale të detyrimeve ndaj shoqërisë ndërtuese.

Të gjitha shpjegimet e subjektit rreth mënyrës së fitimit të kësaj pasurie, pjesës takuese, kontributit të saj dhe atij të mbetur pezull sepse do të paguhet prej vëllait të saj, në një situatë aspak logjike dhe realiste për një periudhë të gjatë kohe, prej të paktën 12 vitesh, krijojnë bindjen se subjekti nuk zotëron në këtë pasuri vetëm pjesën prej 1/3, e ardhur sipas trashëgimisë ligjore, por ajo gëzon në mënyrë të plotë pronësinë mbi të.

- 17.** Trupi gjykues shqyrtoi gjithashtu pretendimet e subjektit të rivlerësimit të ngritura në drejtim të analizës tërësore financiare të kryer nga Komisioni, më të cilat kundërshton si të padrejta konkluzionet lidhur me: **(i)** huanë nga mbesa, në shumën 2.600 euro, të deklaruar në DVP-2004, duke pretenduar se nuk janë konsideruar shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, në të cilat ka shpjeguar se kjo shumë ka qenë dhuratë e vëllait të saj; **(ii)** konsiderimin si pasuri të fshehur të subjektit të shumës 990.000 lekë, e cila është depozituar në “cash” nga nëna e saj në bankë, në janar 2017, pasi

pretendon se kjo shumë është krijuar nga dhurimet e herëpashershme të shumave monetare që vëllai (djali) i ka dhuruar nënës, për të cilat analizon sa vijon.

17.1. Në vendimin e Komisionit lidhur me huanë e marrë prej subjektit të rivlerësimit nga mbesa, në shumën 2.600 euro, të deklaruar në DVP-2004, është konkluduar se: *duke marrë në konsideratë faktin se, pas analizës financiare të pasqyruar më lart, në tabelat nr. 1, 2 e 5 të këtij vendimi, rezulton se të ardhurat e ligjshme të shtetasit F. L., në periudhën 1996 – 2004, nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës, çmon se deklarimi i subjektit të rivlerësimit, që shuma 2.600 euro ka qenë dhuratë nga vëllai i saj, nuk mbështetet në dokumentacionin justifikues. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shumën 2.600 euro në vitin 2004, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.*

17.2. Në funksion të shqyrtimit të pretendimit të subjektit rreth pabazueshmërisë së këtij konkluzioni të Komisionit, trupi gjykues analizoi të dhënat që rezultojnë nga aktet e fashikullit të hetimit, nga të cilat konstatoi se:

i. Në DVP-në 2004, subjekti ka deklaruar: *Gjendje “cash” 2.600 euro të mbesës në Itali, data e krijimit të pasurisë: 23.7.2004.* Në seksionin e “Detyrimeve financiare”, ka deklaruar: *Lekë në përdorim të mbesës në Itali, 2.600 euro.*

ii. Në DVP-të vijuese deri në vitin 2017, subjekti nuk ka deklaruar asgjë për vlerën *cash* 2.600 euro.

iii. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti nuk ka kryer asnjë deklaram lidhur me gjendjen *cash* 2.600 euro.

Në procesverbalin e datës 15.1.2016, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar: *Në lidhje me huanë e deklaruar 2.600 euro, sqaroj se kjo shumë ka qenë dhuratë nga vëllai F., që jeton e banon në Itali dhe meqenëse në këtë periudhë e kisha “cash” në banesë, e kam deklaruar, por më mbrapa kjo shumë është përdorur për nevojat e mia.*

17.3. Në fashikullin e hetimit administrativ, gjendet një deklaratë me shkrim dore, e lëshuar nga vëllai i subjektit, z. F. L., të cilën subjekti e ka përcjellë në Komision në përgjigje të qëndrimit të Komisionit “se mungon dokumentacioni ligjor justifikues për krijimin e likuiditeteve *cash* në vitin 2004, në vlerën 2.600 euro”. Në këtë deklaratë (e cila është pa datë), vëllai i subjektit përshkruan punësimin e tij në Itali nga viti 1992 dhe shpjegon se deri në vitin 1996, ka punuar pa dokumente, dhe se vetëm pas këtij momenti ka mundur të ketë një kontratë të pjesshme pune të rregullt, edhe pse ai punonte me kohë të plotë. Në këtë deklaratë, vëllai i subjektit deklaroi se shumën 2.600 euro që motra e tij e ka deklaruar në DVP-2004, se i ka pasur *cash* në shtëpi, i është dhuruar prej tij për ta përdorur për nevoja të saj dhe të prindërve.

17.4. Rezulton se kjo deklaratë e vëllait të subjektit, jo vetëm që nuk mbështetet nga të dhëna/dokumentare të kohës që provojnë të ardhurat nga punësimi i tij në Itali, por as identifikon vlerat e të ardhurave që janë siguruar nga punësimi i tij në Itali. Në të tilla kushte, trupi gjykues çmon se kjo deklaratë e pambështetur në prova, nuk mund të mjaftojë për të provuar faktin që kjo shumë është dhuruar nga vëllai i subjektit dhe as për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave, të cilat kanë mbetur tërësisht të paidentifikuara.

17.5. Në kushtet kur shuma 2.600 euro është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si e disponuar prej saj në DVP-2004, ajo është pozicionuar në analizën financiare të vitit 2004 si nga Komisioni, po ashtu dhe nga Kolegji, si pasuri në formën e likuiditetit *cash*. Meqenëse, sipas subjektit, kjo shumë ka qenë

dhurimi i kryer prej vëllait, Komisioni me të drejtë ka analizuar burimet e ligjshme të të ardhurave të vëllait deri në korrik të vitit 2004, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, në këndvështrim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se ato mungojnë dhe nuk justifikojnë krijimin e shumës së deklaruar si gjendje *cash* prej subjektit në DVP-2004, në shumën 2.600 euro. Sipas analizës financiare të kontrolluar nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj, rezulton se vëllai i subjektit të rivlerësimit gjendet çdo vit me mungesë burimesh të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës për familjen e tij. Në vlerësimin e trupit gjykues, pamundësia e vëllait të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me të ardhura të ligjshme kostot e jetesës në nivel varfërie për familjen e tij me banim në Itali përgjatë periudhës 1996-2004³³, është një situatë e cila pamundëson objektivisht krijimin me burime të ligjshme prej tij, të shumës 2.600 euro të pretenduar nga subjekti si të dhuruar nga vëllai në vitin 2004.

17.6. Me tej, trupi gjykues mori në analizë pretendimin e subjektit të rivlerësimit me të cilin kundërshton si të padrejtë konkluzionin e Komisionit që konsideron si pasuri të fshehur të subjektit shumën prej 990.000 lekësh, depozituar në “cash” nga nëna e saj në BKT, pasi pretendon se kjo shumë është krijuar nga dhurimet e herëpashershme të shumave monetare që vëllai (djali) i ka dhuruar nënës, për të cilin analizon si vijon.

17.7. Në vendimin e Komisionit, lidhur me depozitimim më datë 5.1.2017, të shumës prej 990.000 lekësh nga nëna e subjektit, është analizuar dhe konkluduar sa vijon:

[...] në kushtet kur: (i) subjekti jeton me nënën e saj; (ii) evidentohet depozitimi “cash” i shumës 990.000 lekë nga nëna e subjektit përpara dorëzimit të deklarates “vetting”; (iii) subjekti ka deklaruar se kjo shumë ka si burim të ardhurat e vëllait të saj ndër vite; (iv) nisur edhe nga fakti që subjekti ka deklaruar kontributin e vëllait të saj në deklaratimet periodike në krijimin e disa pasurive të paluajtshme të trajtuara më sipër – Komisioni, për të shteruar çdo dyshim lidhur me faktin nëse kjo është një pasuri e subjektit, bazuar në nenet 30 e 45 të ligjit nr. 84/2016, hetoi lidhur me mundësitë financiare të vëllait të subjektit/F. L. dhe nënës së subjektit për krijimin e shumës 990.000 lekë, në datën 9.1.2017. [...] Sa më sipër, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova shtesë apo shpjegime bindëse lidhur me konstatimin e rezultateve të hetimit se të ardhurat e ligjshme të shtetasit F. L. nuk mbulojnë shpenzimet e jetesës dhe përjashtohet mundësia për të pasur burime të ligjshme për dërgimin e shumës 990.000 lekë, trupi gjykues vlerëson se ka dyshime të arsyeshme se kjo shumë, e depozituar në bankë nga nëna e subjektit në datën 5.1.2017, është pasuri e subjektit. Në përfundim, Komisioni vlerëson se krijohen dyshime të arsyeshme se shuma 990.000 lekë është pasuri e subjektit të rivlerësimit, duke u përpjekur të fshehtë nga kontrolli dhe verifikimi burimet e krijimit të saj, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

17.8. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, jep të njëjtat shpjegime me ato të paraqitura në Komision me përgjigjet për rezultatet paraprake të hetimit, lidhur me të ardhurat e vëllait, dhe rithekson se ajo ka dhënë shpjegime bindëse në hetimin administrativ për sa i përket faktit se vëllai ka pasur të ardhura më se të mjaftueshme për të krijuar pasuri, ashtu edhe për të krijuar gjendje *cash*. Subjekti pretendon se vëllait të saj, prej Komisionit, i është bërë analizë financiare në mënyrë të gabuar, pasi ai nuk plotëson kushtet për t’u konsideruar si person tjetër i lidhur me subjektin, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

³³ Sipas të dhënave të marra nga shkresa me nr. {***}, datë 24.07.2023, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, mbi hyrje-daljet në kufi, janë identifikuar datëlindjet e fëmijëve të shtetasit F. L., respektivisht: I. L., datë 11.11.1994; F. L., datë 13.10.1998 dhe F. L. në datë 24.02.2001.

17.9. Lidhur me pretendimin e subjektit se, në Komision, ka dhënë shpjegime bindëse për të ardhurat e vëllait, trupi gjykues konstaton se ato nuk gjejnë mbështetje në aktet e depozituara prej saj. Nga analiza kontrolluese e kryer në Kolegj mbi atë të kryer në Komision, konfirmohet fakti se vëllai i subjektit, sërish duke përdorur për shpenzimet e jetesës standardet e nivelit të varfërisë, nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme as për të përballuar kostot e jetesës së familjes së tij në Itali deri në janar 2017, dhe aq më pak për të përballuar krijimin e likuiditeteve në shumën prej 900.000 lekësh, të depozituar në emër të nënës së subjektit. Në këto kushte, rezulton se shuma prej 990.000 lekësh që nëna e subjekti e ka depozituar *cash* në bankë, në janar 2017, e për të cilën subjekti ka deklaruar se është krijuar nga dhurimet që i ka bërë nënës vëllai i saj, mbetet e pambuluar me burime të ligjshme.

17.10. Pretendimet e subjektit se kontrolli i ushtruar nga Komisioni mbi këtë pasuri, është në tejkalim të parashikimeve ligjore, pasi vëllai i saj nuk gëzon statusin e personit tjetër të lidhur për shkak se nëna e saj është përfituese e dhurimit prej tij të shumës objekt kontrolli, nuk gëzon statusin e personit të lidhur, trupi gjykues i gjen të padrejta në thelb, për shkak të orientimit nga një kualifikim i ndryshëm nga ai që ka përdorur Komisioni për kryerjen e kontrollit, të cilin trupi gjykues e gjen të drejtë. Në analizë të situatës faktike, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me anë të ligjit nr. 76/2016, si dhe të plotësimit të deklaratës *vetting*, nuk ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me nënën e saj G. L.³⁴. Pavarësisht kësaj, ajo vetë ka deklaruar se gjatë gjithë jetës së saj ka jetuar me prindërit, edhe për shkak të statusit të saj civil, dhe me nënën në kohën e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, rrethanë që provon faktin se kanë qenë në të njëjtën ekonomi familjare, i cili duket se ka diktuar edhe plotësimin nga nëna e subjektit të shtojcës së deklaratës së pasurisë *vetting*, si të ishte person i lidhur me të. Nisur nga kjo situatë, ndonëse deklaratimet e subjektit janë në tejkalim të detyrimeve ligjore që vijnë nga ligji nr. 84/2016, rrethanat që kanë përcaktuar orientimin e Komisionit drejt kontrollit të pasurisë së nënës së subjektit, ndonëse jo me cilësinë e personit të lidhur, konstatohen se janë: **(i)** së pari, deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit që e kanë ekspozuar nënën e saj ndaj kontrollit të pasurisë të bërë nga Komisioni, duke qenë se e kanë konsideruar si një person të lidhur financiarisht me të, për shkak të jetesës në një ekonomi të përbashkët; **(ii)** lidhja e afërt e gjakut me nënën e saj, e cila edhe në rast se nuk do të shoqërohej me deklarime në deklaratën e pasurisë *vetting*, mund ta çonte sërish Komisionin në zbatim të procedurave e praktikave të hetimit të thelluar administrativ të aplikuara prej tij për të gjitha subjektet e rivlerësimit, të kërkonte informacion dhe të kryente hetime nga institucionet bankare dhe zyrat e regjistrimit të pasurive edhe për të. Në këtë kontekst, Komisioni do të kishte marrë informacionin për depozitimin në *cash* të një shume të tillë në bankë nga nëna e subjektit disa ditë para plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, edhe pa pasur deklarime në të; **(iii)** në kushtet kur në mënyrë të përsëritur, subjekti i rivlerësimit, si në deklaratën e pasurisë *vetting*, por edhe gjatë hetimit administrativ, deklaronte se shuma e depozituar nga nëna, *cash*, në vlerën 990.000 lekë, më 5 janar 2017, është krijuar me burim të ardhurat e sjella nga vëllai emigrant i subjektit, z. F. L., dhe nëna nuk ka asnjë burim tjetër të identifikuar prej saj për të krijuar këtë shumë, me të drejtë Komisioni ka kontrolluar burimet e vëllait për të pasur një konkluzion mbi këtë pasuri; **(iv)** fakti që, sipas të

³⁴ Nga informacioni i administruar në fashikullin e ILDKPKI-së, gjendet certifikata familjare e subjektit, e lëshuar më datë 19.01.2017, nga Bashkia Shkodër, Njësia Administrative {***}, nr. {***}, në të cilën pasqyrohet gjendja familjare e subjektit në vitin 1992, nga e cila rezulton se Françeskina Lekani ishte në përbërje familjare vetëm me vëllanë, z. F. L., i cili figuronte si kryefamiljar.

gjitha analizave të kryera për mundësitë e vëllait të subjektit për të realizuar të ardhurat e përdorura për pasuritë e disponuara prej vetë subjektit dhe të kësaj pasurie të disponuar prej nënës së saj, rezulton se ai është me mungesë të theksuar të të ardhurave për të justifikuar shpenzimet e jetesës së familjes së tij dhe, në asnjë rast, për të krijuar pasuri të tjera, në vlerësimin e trupit gjykues, është një rrethanë e cila në mënyrë të logjikshme, justifikon konsiderimin prej Komisionit se edhe kjo pasuri duket se është pasuri e fshehur e subjektit, për të cilën, me të drejtë, i ka kaluar barrën e provës. Subjekti i rivlerësimit rezulton se, në mënyrë të përsëritur, ka përdorur të ardhurat e vëllait të saj, të cilat nuk provohet se kanë qenë të mundshme për t'u siguruar, si burim për krijimin e pasurive të deklaruara prej saj dhe prindërve së saj, të cilët kanë jetuar pothuaj prej gjithë jetës në një ekonomi të përbashkët me të, panoramë e cila krijon bindjen që, në mungesë të burimeve të vetë subjektit, këto të ardhura janë përdorur si mburojë për justifikimin e tyre.

17.11. Në këto rrethana, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, vlerëson se, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë se vëllai i saj ka pasur të ardhura të ligjshme për t'i dhuruar nënës shumë 990.000 lekë dhe as ka provuar modalitetet për sjelljen prej tij të kësaj shume në Shqipëri, nuk ka arritur të provojë burimet e ligjshme të krijimit të kësaj shume të disponuar prej nënës së saj, të ardhurat e së cilës janë të pamundura gjithashtu ta justifikojnë atë (sipas deklarimeve të bëra nga vetë nëna e subjektit në deklaratën *vetting*, ajo përfiton një pension pleqërie në shumë prej 14.500 lekësh në muaj) – kjo situatë konstatohet të jetë e njëjtë edhe me shqyrtimin e ankimit dhe qëndrimi i Komisionit se shuma 990.000 lekë është pasuri e fshehur e saj, mbetet një konkluzion i drejtë.

17.12. Në përfundim, lidhur me depozitimin *cash* të shumës 990.000 lekë nga nëna e subjektit G. L., trupi gjykues konfirmon qëndrimin e Komisionit se krijohen dyshime të arsyeshme se kjo shumë është pasuri e subjektit të rivlerësimit, të cilën ajo është përpjekur ta fshehtë nga kontrolli dhe verifikimi për burimet e krijimit të saj, duke e vendosur në emër të nënës. Për pasojë, subjekti gjendet, edhe për këtë pasuri, në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vëren se në analizën e bërë për këtë pasuri, vlejnë të gjitha argumentet e analizuara edhe për pasuritë më sipër, për sa u përket mundësive të vëllait të subjektit për të krijuar këtë shumë të deklaruar si dhuratë ndaj nënës së saj. Gjithashtu, në këtë konkluzion, sillet në vëmendje se subjekti ka përdorur të njëjtin mekanizëm për të fshehur pasuritë e mara në analizë, duke i vendosur ato në emër të familjarëve, të cilët, për më tepër, nuk rezultojnë të kenë burime të ligjshme për t'i krijuar ato.

18. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues, duke përfunduar shqyrtimin e shkaqeve të ankimit që lidhen më kryesisht me vlerësimin të pasurisë, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani, nuk arrin një nivel të besueshëm në lidhje me këtë kriter, dhe se ajo gjendet në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016

ii. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe cenimin e besimit të publikut

19. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me analizën mbi çështjet e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale dhe cenimin e besimit të publikut, duke pretenduar se: (i) për procedimin penal nr. {***}/2016, konstatimet e Komisionit nuk janë të drejta; (ii) për kallëzimet penale ndaj subjektit nr.

{***}/2014³⁵, nr. {***}/2016³⁶, si dhe për procedimin penal nr. {***}/2020, Komisioni nuk ka konsideruar se për një pjesë prej tyre është kaluar filtri i kontrollit të ILD-së, dhe se vendimmarrjet e subjektit janë konfirmuar nga gjykata; (iii) konkluzioni i Komisionit për procedimin penal nr. {***}/2022, se ka vepruar në kundërshtim me parimin e paanësisë, si i vetëm, nuk mund të mjaftojë për të konkluduar se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, pasi duhet vlerësuar duke aplikuar parimet e proporcionalitetit dhe të objektivitetit.

19.1. Subjekti i rivlerësimit gjithashtu pretendon se *në vendimin e Komisionit, mungon konkluzioni lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, dhe gjetjet e konstatuara në këtë kriter, janë përdorur në mënyrë të padrejtë për të konkluduar se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.*

19.2. Trupi gjykues mori në shqyrtim këto pretendime, duke i analizuar ato në raport me secilin prej procedimeve të shtruara për kontroll, e veçanërisht ato që janë përdorur prej Komisionit si bazë për të konkluduar se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë³⁷. Në këtë kontekst, trupi gjykues arriti në përfundime të ndryshme lidhur me kualifikimin ligjor të shkeljeve të konstatuara, siç do të arsyetohet në vijim, duke i dhënë përgjigje në këtë mënyrë edhe pretendimit të subjektit se Komisioni nuk ka marrë një qëndrim përfundimtar për këtë kriter, por ka bërë një vlerësim të gjetjeve që burojnë në kuadër të tij, nën optikën e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

19.3. Lidhur me procedimin penal nr. {***}/2016, regjistruar në ngarkim të shtetasit P. K., për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, të parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal, në vendimin e Komisionit është konkluduar se: *Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kriteret që parashikohen në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.*

19.4. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, jep të njëjtat shpjegime si në Komision³⁸, duke pretenduar se moskryerja e aktekspertimit për armën e gjahut, është bërë për shkak të faktit se sistemi automatik

³⁵ Ky kallëzim penal, i bërë ndaj subjektit, lidhet me procedimin penal nr. {***}/2013, të shqyrtuar prej saj.

³⁶ Ky kallëzim penal, i bërë ndaj subjektit, lidhet me procedimin penal nr. {***}/2012, të shqyrtuar prej saj.

³⁷ Referuar përmbajtjes së vendimit objekt shqyrtimi, rezulton se Komisioni, për analizimin e kriterit të vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, si burime ka përdorur të dhënat e arkivit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të KLP-së, nga të cilat ka rezultuar se ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani: (i) me urdhrin nr. {***}, datë 31.07.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, i është dhënë masa disiplinore “vërejtje”; (ii) nga informacioni i administruar në KLP, rezulton se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ndaj subjektit të rivlerësimit kanë regjistruar disa kallëzime penale, përkatësisht me nr. {***} i vitit 2016; nr. {***} i vitit 2016; nr. {***} i vitit 2014 dhe nr. {***} i vitit 2016; (iii) gjithashtu Komisioni ka kryer hetim të pavarur edhe për çështjet penale të analizuar në raportimin e KLP-së për subjektin e rivlerësimit.

³⁸ Në Komision subjekti ka shpjeguar se:

“Lidhur me sa më lart, sqaroj se procedimi penal në fjalë nuk ka qenë një procedim i filluar nga Prokuroria Shkodër, por ka ardhur si procedim i ndarë nga Prokuroria Lezhë. Nga kjo e fundit, është sjellë për kompetencë vetëm fakti i mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të gjitha veprimet e tjera hetimore janë kryer nga Prokuroria Lezhë. Shtetasi P. K. ka rezultuar si person i dyshuar gjatë hetimeve të kryera nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila, gjatë hetimeve paraprake, ka ushtruar kontroll banese në banesën e këtij shtetasi. Gjatë kontrollit i janë sekuestruar dhe dy armë gjahu. Në vijim, nga Prokuroria Lezhë, janë kryer të gjitha veprimet procedurale përkatëse, ekspertimet tekniko-balistike lidhur me armët e sekuestruara, dhe në momentin që janë kryer të gjitha verifikimet e nevojshme lidhur me përfshirjen apo jo

i databazës në Institutin e Policisë Shkencore, nuk mban të regjistruara të dhënat e gëzhgojave të armëve të gjahut për ngjarjet e mëparshme. Për këtë arsye, sipas subjektit, krahasimi nëse një armë gjahu është përdorur apo jo në ngjarje të mëparshme, është i pamundur dhe nuk bëhet në asnjë rast.

19.5. Trupi gjykues, lidhur me këtë shpjegim të subjektit, vlerëson se ai duket se nuk i jep përgjigje pyetjes përse subjekti nuk ka kryer aktin e ekspertimit të armëve të zjarrit të sekuestruara në vendngjarje, për të hetuar rreth mundësisë së përdorimit të tyre në ngjarje të mëparshme kriminale, si një veprim hetimor pothuaj i standardizuar në rastet e gjetjes/sekuestrimit të armëve luftarake. Pretendimi i subjektit se *nuk ka databazë për armët e gjahut*, për sa kohë nuk është i bazuar në një konfirmim të tillë nga struktura përgjegjëse, mbetet një qëndrim i hamendësuar. Nevoja për kryerjen e një akteksptertimi që lidhet me faktin nëse armët e gjahut janë përdorur apo jo më parë në vepra penale, për më tepër, duket se ka qenë e nevojshme dhe e logjikhme në kushtet e procedimit penal konkret, i cili duket se ka startuar edhe prej personalitetit të të dyshuarit, i cili njihej si person i shoqërueshëm me individë me rekorde kriminale.

19.6. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se konkluzioni i Komisionit se në lidhje me procedimin penal nr. {***} të vitit 2016, subjekti *ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të ndërmarrë logjikhisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj*, është i drejtë dhe i argumentuar, ndonëse nuk vlerësohet se zë një peshë specifike të rëndësishme në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit.

19.7. Lidhur me dosjen penale të administruar në kuadër të materialit kallëzues ndaj subjektit të rivlerësimit, me nr. {***}/2014, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, *me të cilat kundërshton si të padrejta dhe të pabazuara ligjërisht konkluzionet e Komisionit lidhur me veprimtarinë hetimore të kryer prej saj në kuadër të procedimit penal nr. {***}/2013*, për të cilat analizon si vijon.

19.8. Në vendimin e Komisionit, lidhur me veprimtarinë hetimore të subjektit të rivlerësimit në çështjen e marrë në shqyrtim e të përshkruar më sipër, kanë rezultuar faktet dhe analiza e mëposhtme. *Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale, rezulton se bazuar në kallëzimin e shtetasit E. K., Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. {***} të vitit 2013, i cili është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit. Në këtë kallëzim, kallëzuesi ka deklaruar se nga viti 2009, jeton në Kanada dhe në dhjetor të vitit 2012 është vënë në dijeni se pranë autoriteteve kufitare është paraqitur nga shtetasi A. V. një certifikatë familjare e tij, e shoqëruar me dokumentin “Vërtetim i njësisë me origjinalin”, i datës 20.9.2011, i lëshuar nga noteri P. Z. në emër të kallëzuesit. Kallëzuesi ka pretenduar se në kohën e lëshimit të dokumentit nga noteri, nuk ka qenë në Shqipëri, por në Kanada, duke paraqitur edhe dokumentet e sistemit kufitar kanadez. Në vijim, ka pretenduar se në regjistrin e noterit, në të njëjtin rresht, janë kryer veprime në emër të një shtetasi tjetër, me emrin V. A. Nga këqyrja e regjistrit noterial, ka rezultuar se veprimi noterial i lartpërmendur ndodhet i regjistruar në të njëjtin rresht me shënimin e bërë për veprimet e kryera nga shtetasi V. A. Noteri*

të këtij shtetasi në ngjarjen në fjalë, është bërë ndarja e procedimit dhe aktet i kanë kaluar Prokurorisë Shkodër për verifikimin e faktit nëse armët në fjalë ishin apo jo me leje”.

Megjithatë, dua të theksoj se sistemi automatik i databazës në IPSH, nuk mban të regjistruara të dhënat e gëzhgojave të armëve të gjahut të ngjarjeve të mëparshme. Për këtë arsye, krahasimi nëse një armë gjahu është përdorur apo jo në ngjarje të mëparshme, është i pamundur dhe nuk bëhet në asnjë rast”.

P. Z. ka deklaruar se nuk e kujton si rast, por duke iu referuar shënimeve në regjistër, mendon se këta dy shtetas duhet të kenë qenë njëkohësisht në zyrën e tij për kryerjen e të njëjtit veprim, “Vërtetim me origjinalin” dhe, si pasojë e ngarkesës atë ditë, duhet të jetë bërë shënimi në të njëjtin rresht. Në deklarimin e tij, shtetasi V. A. ka deklaruar se është paraqitur te zyra noteriale për të kryer veprimin për vërtetësinë e një dokumenti, “Makinë gjermane”, nuk e njeh shtetasin E. K. dhe nuk kujton të ketë kryer ndonjë transaksion me këtë person.

*Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 15.7.2013, ka vendosur pushimin e procedimit penal, duke arsyetuar se nuk është konsumuar vepra penale “Shpërdorimi i detyrës” nga noteri, pasi veprimet e kryera nga ana e tij, figurojnë në regjistrin noterial, pavarësisht se në të njëjtin rresht regjistri, dhe nuk provohet që noteri e ka kryer me dashje këtë regjistrim. Pasi është njohur me këtë vendim, kallëzuesi ka paraqitur kallëzim penal ndaj prokurores Françeskina Lekani në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila, më pas, i ka përcjellë aktet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Në vijim, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar kallëzimin penal nr. {***}/2014 dhe prokurori i çështjes, me vendimin e datës 10.6.2014, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se nga veprimet e kryera dhe nga vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nuk ka elemente të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. [...]*

Gjithashtu, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit, në vendimin e saj, nuk ka analizuar elementet e anës objektive të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në raport me faktet e vërtetuara gjatë hetimit, pasi nuk ka analizuar: (i) nëse veprimet e noterit përbëjnë ose jo mospërmbushje të rregullt të detyrës; (ii) pasojat e këtyre veprimeve nëse noteri ka siguruar përfitime materiale ose jomateriale për vete apo persona të tjerë, ose nëse ka shkaktuar dëmtimin e interesave të ligjshëm të kallëzuesit.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në aftësinë për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsyetimit ligjor, duke u bazuar në tregues të tillë, si cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit, kritere të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

19.9. Subjekti i rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani, në ankim, pretendon se në dhënien e vendimit për pushimin e procedimit penal nr. {***}/2013, ka vepruar mbi bindjen e saj të brendshme dhe se Komisioni, në vendim, nuk ka arsyetuar përse bindja e saj e brendshme nuk është bërë në përputhje me ligjin. Subjekti shpjegon se nuk ka konkluduar se fakti nuk ekziston apo se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, por ka konkluduar se nuk mund të provohet dijenia dhe dashja e noterit, pasi në zyrën e tij mund të jetë paraqitur një person tjetër, me një mjet identifikimi të falsifikuar, dhe se nuk provohet se noteri ka pasur arsye të dyshojë se dokumenti ka qenë i falsifikuar.

19.10. Trupi gjykues konstaton se shpjegimi i mësipërm i subjektit të rivlerësimit nuk i ka dhënë përgjigje konstatimit të Komisionit se kanë munguar hetimet për faktin nëse veprimet e noterit përbëjnë ose jo mospërmbushje të rregullt të detyrës, që në këtë rast kishin të bënin me faktin se subjekti duhet të hetonte nëse noteri kishte treguar kujdesin e duhur për të verifikuar si duhet prezencën e palëve dhe për ta referuar atë në regjistrat përkatës. Në vendimin “Për pushimin e procedimit penal nr. {***}, të vitit 2013”, të datës 15.07.2013, vetë subjekti i rivlerësimit evidenton se: Nga procesverbali i këqyrjes dhe marrjes së dokumentit (regjistri noterial), datë 11.04.2013, ka rezultuar se veprimi noterial i lartpërmendur (pra, ai i noterizuar në emër të E. K.) ndodhet i regjistruar në regjistrin e veprimeve noteriale, në të njëjtin rresht regjistri, ku është bërë shënimi për veprimet e kryera nga shtetasi V. A. Në vlerësimin e trupit gjykues, kjo situatë në vetvete, në ndryshim nga sa pretendon subjekti, duket se evidenton qartë se noteri nuk ka kryer si duhet as procedurat e

regjistrimit të aktit të mësipërm, të cilin nga ky përshkrim nuk kuptohet nëse e ka referuar në regjistër vetëm si numër akti, apo për këtë numër akti ka referuar se janë veprime që i takojnë shtetasit V. A. Në këto kushte, në mungesë të qartësisë rreth veprimeve të kryera prej noterit, mbetet e paqartë se si subjekti ka analizuar anën subjektive të veprës penale, duke arritur në përfundimin se noteri P. Z. nuk e ka kryer me dashje regjistrimin e aktit që ka dalë në emër të shtetasit E. K., në të njëjtin rresht apo numërtim me dy akte të tjera të asaj dite, përpos që është nënshkruar jo nga personi në emër të të cilit ka dalë. Po ashtu, trupi gjykues konstaton se në vendimin e pushimit të procedimit penal të sipërcituar, subjekti i rivlerësimit shprehet se: *[...] nga ana jonë, nuk mund të provohet se në zyrën noteriale është paraqitur një person tjetër për të kryer veprimet që pretendon kallëzuesi (E. K.), pasi mungon praktika e cila është asgjësuar sipas udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005.* Ky qëndrim i subjektit duket se vjen tërësisht në kundërshtim me provat që kallëzuesi ka paraqitur pranë Oficerit të Policisë Gjyqësore, të cilat janë të dhënat e Shërbimit të Kufirit të shtetit kanadez, që tregojnë për prezencën e tij në territorin e këtij shteti në vitin 2013, kohë në të cilën në Shqipëri është noterizuar akti në emër të tij. Kjo e dhënë e administruar në fashikullin penal dhe e përcjellë me kallëzimin, duhet të verifikohet e vlerësohet nga ana e subjektit edhe nëpërmjet kryerjes së një ekspertimi grafik të nënshkrimeve, për të sqaruar faktin nëse akti noterial i pretenduar është kryer ose jo në prezencë të kallëzuesit dhe, më pas, për të analizuar përgjegjësinë e noterit mbi këtë fakt.

19.11. Në përfundim, trupi gjykues, në këndvështrim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, se ajo ka vepruar mbi bindjen e brendshme, vlerëson se nga sa analizuar më sipër, vendimi i subjektit, i datës 15.07.2013, me të cilin ka vendosur pushimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. {***} të vitit 2013, është marrë në mungesë të kryerjes së një veprimtarie të plotë dhe të nevojshme hetimore, me qëllim verifikimin e të dhënave të servitura me anë të kallëzimit. Të dhënat e rastit sugjerojnë një hetim të plotë të fakteve të pretenduara e *quasi* të provuara në kallëzim, që kishin nevojë t'i nënshtroheshin hetimit penal të gjithanshëm për të dalë në një konkluzion të drejtë lidhur me zgjidhjen e çështjes. Vlerësimi i subjektit se ato nuk provonin dashjen e noterit, duket se ka qenë sipërfaqësor dhe i pajustifikuar në kontekstin e rrethanave konkrete të rastit, jo si një produkt i analizës dhe bindjes së brendshme, por si një produkt i mangësive profesionale që kanë shmangur një hetim logjik të fakteve e, për pasojë, kanë deformuar dhe vetë "bindjen e brendshme të subjektit".

19.12. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se konkluzioni i Komisionit për mangësitë e vërejtura për subjektin e rivlerësimit, lidhur me trajtimin që i ka bërë procedimit penal si më sipër analizuar, është i drejtë dhe i bazuar ligjërisht dhe se subjekti gjendet në kushtet e cenimit të nënindikatorëve të parashikuar nga neni 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

19.13. Lidhur me dosjen penale të administruar në kuadër të materialit kallëzues ndaj subjektit të rivlerësimit, me nr. {***}/2016, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat kundërshton si *të padrejta dhe të pabazuara ligjërisht konkluzionet e Komisionit lidhur me veprimtarinë hetimore të kryer prej saj në kuadër të procedimit penal nr. {***}/2012*, për të cilat analizon si vijon.

19.14. Komisioni, pasi ka analizuar këtë çështje, ndër të tjera, ka konkluduar se: *Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale, rezulton se shtetasit L. dhe Z. H. kanë paraqitur kallëzim penal për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", me shkakun se dokumentet, mbi bazën e të cilave është mbështetur vendimi i KKKP-së në favor të trashëgimtarëve të të ndjerit P. D. janë të falsifikuara,*

*pasi në hartat e vitit 1938 objekti nuk ekziston, por shfaqet në hartat e vitit 1964, çka, sipas tyre, provon se është një objekt i ndërtuar nga shteti dhe, për pasojë, duhet të hetohet nga ana e prokurorisë se në ç'mënyrë është bërë i mundur pasqyrimi i objektit. Në kuadër të këtij kallëzimi, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar kallëzimin penal nr. {***/2012. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 11.1.2013, ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. {***/2012, me arsyetimin se pretendimet e kallëzuesve janë verifikuar në gjykimin civil dhe janë gjendur të pabazuara. Kundër këtij vendimi, kallëzueset kanë paraqitur ankim në gjykatë. [...]*

*Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin e datës 11.1.2013, për pushimin e procedimit penal, me arsyetimin se pretendimet e kallëzuesve, lidhur me falsifikimin e dokumenteve, janë shqyrtuar në gjykimin civil, duke mos u shprehur lidhur me konsumimin e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale, sikurse ka shpjeguar në përgjigje të rezultateve të hetimit. Në vijim, nga shqyrtimi i vendimit nr. {***}, datë 27.5.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ku është trajtuar çështja civile së cilës i referohet subjekti i rivlerësimit, nuk rezulton që pala e paditur L. dhe Z. H., gjatë gjykimit, të kenë ngritur pretendime lidhur me falsifikimin e dokumenteve të paraqitura nga pala paditëse në KKKP dhe këto pretendime të jenë vlerësuar nga gjykatat. Për pasojë, duket se arsyetimi i subjektit të rivlerësimit në vendimin e datës 11.1.2013, për pushimin e çështjes penale nr. {***/2012, nuk është i mbështetur në vendimet gjyqësore të marra në gjykimin civil. Për pasojë, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse lidhur me konstatimet e rezultateve të hetimit, se ka marrë vendimin e datës 11.1.2013 për pushimin e çështjes penale nr. {***/2012, pa kryer veprimet e nevojshme hetimore.*

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

19.15. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, lidhur me këto konkluzione, pretendon se ato i përkasin një çështjeje e cila ka kaluar filtrin e kontrollit gjyqësor deri në Gjykatën e Lartë, e cila, pas shqyrtimit, ka lënë në fuqi vendimmarrjen e subjektit lidhur me të. Në këto kushte, subjekti pretendon se shprehja ose jo prej saj, lidhur me afatet e parashkrimit, nuk e cenon në thelb vendimin e marrë prej saj dhe as ligjshmërinë dhe besueshmërinë e këtij vendimi.

19.16. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi nga aksesimi i drejtpërdrejtë në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, se me anë të vendimit nr. {***}, datë 30.01.2024, kjo gjykatë ka marrë në shqyrtim çështjen penale {***}, e cila i përket rekursit të paraqitur nga L. H. e Z. H., me objekt “Kundërshtimi i vendimit “Për pushimin e procedimit nr. {***} të vitit 2012”, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër”, dhe ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga ankueset kundër vendimit nr. {***}, datë 29.09.2017, të Gjykatës së Apelit Shkodër. Nisur nga të dhënat që pasqyrohen në të, i cili praktikisht “ka lënë në fuqi” vendimin e marrë nga subjekti i rivlerësimit, në çështjen objekt kontrolli, ndonëse nuk ka gjykuar mbi bazueshmërinë e tij, rezulton se duke vendosur për mospranimin e rekursit, Gjykata e Lartë ka konkluduar në thelb se zgjidhja e çështjes nëpërmjet vendimit të pushimit të procedimit penal, nuk paraqet shkelje të ligjit material dhe as procedural, duke u dhënë përgjigje indirekte edhe pretendimeve të ankuesve pranë organeve të rivlerësimit, por duke lënë gjithashtu pa bazë konkluzionet e Komisionit lidhur me këtë çështje, meqenëse ato lidhen drejtpërdrejt me probleme në zbatimin e ligjit, për të cilat kjo gjykatë ka fjalën e fundit.

19.17. Mbështetur në sa më lart, trupi gjykues vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili daton pas dhënies së vendimit të Komisionit, shkon në mbështetje të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me konkluzionet e Komisionit për vendimin e marrë prej saj për pushimin e procedimit penal nr. {***}/2012. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e paraqitura nga subjekti në ankim, lidhur me këto konkluzione, gjenden të drejta.

19.18. Trupi gjykues mori në shqyrtimin pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi konkluzionet e Komisionit lidhur me vendimin e subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal nr. {***}/2020, për të cilin konstaton dhe analizon sa vijon.

19.19. Komisioni, lidhur me këtë procedim, ka arritur në konkluzione të rëndësishme për sa u përket aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke potencuar në konkluzion, ndër të tjera, se *shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, se nuk është arritur të provohet personi i cili ka falsifikuar dokumentet e paraqitura në AKKP dhe në gjykatë dhe dijenia e shtetasit A. B. që këto dokumente ishin të falsifikuara, nuk janë bindëse, në kushtet kur nga hetimi ka rezultuar se: (i) pasuria e paluajtshme tokë, me sip. 39 ha, është përfituar me dokumente të falsifikuara; (ii) dokumentacioni është paraqitur në AKKP e, më pas, në gjykatë nga shtetasi A. B., në cilësinë e përfaqësuesit të shtetases D. H.; (iii) pas përfitimit të pasurisë së mësipërme, shtetasi A. B., në cilësinë e përfaqësuesit të shtetases D. H., këtë pasuri e ka tjetërsuar te shtetasi F. Gj. me anë të kontratës së dhurimit. Për pasojë, mbetet i dyshimtë fakti që ndaj shtetasit A. B. nuk është ngritur akuza për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.*

Në vijim, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shpjegime lidhur me konstatimin e rezultateve të hetimit se nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për vërtetimin e faktit nëse shtetasi P. Gj. ka pasur ose jo dijeni që prona e shtetases D. H. është përfituar me dokumente të falsifikuara dhe nëse ka pasur si qëllim pastrimin e produkteve të veprës penale, nëpërmjet kalimit të pasurisë objekt hetimi babait të tij me anë të kontratës së dhurimit, në kushtet kur kallëzuesja ka pretenduar se: (a) pronën objekt hetimi e ka poseduar vazhdimisht shtetasi P. Gj.; (b) procesi gjyqësor për fitimin e pronës është ndjekur nga S. B., juriste pranë bizneseve të shtetasit P. Gj., Për pasojë, mbetet i dyshimtë fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar marrëdhënien e shtetasit P. Gj. me pronën objekt hetimi dhe dijeninë e tij nëse kjo pasuri, e cila më pas i kaloi me dhurim babait të tij, është përfituar me dokumente të falsifikuara.

Gjithashtu, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime edhe për sa i përket konstatimit të rezultateve të hetimit lidhur me paqartësinë e faktit se përse nuk ka kërkuar konfiskimin e pasurisë tokë me sip. 30 dynymë, e cila i është kthyer si e lirë shtetases D. H., sipas parashikimeve të nenit 36 të Kodit Penal, në kushtet kur nga hetimi ka rezultuar që dokumentet mbi bazën e të cilave është përfituar kjo pasuri, kanë rezultuar të falsifikuara, si dhe në kushtet kur shtetasi K. Gj. e ka përfituar këtë pasuri me kontratë dhurimi. Për pasojë, edhe në këtë rast, mbetet i dyshimtë fakti i mosveprimit të subjektit të rivlerësimit. [...]

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi të theksuara në aspektin e njohurive ligjore, duke u bazuar në tregues të tillë, si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsytimit ligjor, duke u bazuar në cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, kritere që parashikohen në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

19.20. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me konkluzionet e mësipërme të Komisionit, pretendon se, pavarësisht shtjellimit të gjerë të rastit, Komisioni ka anashkaluar haptazi faktin se kjo çështje është referuar me ankim në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë (në vijim “ILD”), dhe ky organ, me vendimin nr. {***}, datë 31.07.2023, ka vendosur *për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës për trajtimin e këtij procedimi penal*. Nisur nga ky fakt, subjekti pretendon se ky rast përbën “gjë të gjykuar” dhe se institucioni përkatës është shprehur për mungesën e shkeljeve dhe rrjedhimisht edhe të elementeve për fillimin e procedimit disiplinor, duke pretenduar se përfundimi i arritur nga Komisioni për këtë çështje, është në kundërshtim me ligjin.

19.21. Trupi gjykues, nga analiza e shkaqeve të ankimit lidhur me këtë procedim, konstaton, *së pari*, se subjekti nuk ka ngritur asnjë kundërshti dhe as nuk ka dhënë shpjegime për problematikat e evidentuara në analizën e Komisionit që lidhen me mungesën e aftësive profesionale të konstatuara, për pasojë, analiza e mëtejshme lidhur me bazueshmërinë e tyre, mbetet jashtë kontrollit të thelluar të trupit gjykues, duke konfirmuar në këtë mënyrë qëndrimet e Komisionit lidhur me to, e duke i konsideruar ato në drejtim të peshës së tyre në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Trupi gjykues, duke konfirmuar të njëjtat qëndrime si Komisioni lidhur me këtë çështje, vlerëson të evidentojë se sjella e subjektit në ankim, e reduktuar vetëm në elemente të natyrës procedurale, për sa kohë që pretendohet shmangia e kontrollit të vendimit të Komisionit për këtë çështje, për shkak të arkivimit që ka bërë ILD-ja, konsiderohet më së paku si një përpjekje për të mos u përballur me profesionalizëm ndaj gjetjeve të rëndësishme e të pashpjegueshme lidhur me konkluzionin se ndjekja penale duhej të pushohej në rastin konkret, referuar vetëm një veprë penale të dyshuar, siç ishte falsifikimi, por duke shmangur krejtësisht nga hetimi vepra të tjera penale, të cilat nuk ishin parashkruar e për të cilat duhej se kishte elemente të mjaftueshme për vijimin e hetimit. Po ashtu, asnjë shpjegim nuk paraqitet në ankim lidhur me sjelljen pasive të subjektit të rivlerësimit në trajtimin e pasurisë së përfituar me anë të dokumenteve të falsifikuara, e cila, për shkak të kësaj veprimtarie kriminale, është rritur fiktivisht e padrejtësisht nga 39 dynymë, në 390 dynym tokë, në dëm të interesave shtetërorë e të qytetarëve. Ky qëndrim i saj, vlerësohet nga trupi gjykues se tregon qasjen e subjektit ndaj problematikave të konstatuara dhe mungesë totale të argumenteve mbrojtëse.

19.22. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se: *Komisioni ka anashkaluar faktin se ky procedim penal është shqyrtuar nga ILD-ja*, trupi gjykues vlerëson të sjellë në vëmendje qëndrimin e konsoliduar të institucioneve të rivlerësimit në raport me verifikimin paralel që bëjnë organet e juridiksionit të zakonshëm për çështje të njëjta, qëndrim i cili është bërë i qartë edhe në vendimin objekt shqyrtimi, sipas të cilit, qëndrimi i ILD-së lidhur me një çështje nuk është detyrues dhe as pengues, për sa kohë institucionet e rivlerësimit hetojnë dhe vlerësojnë në mënyrë të pavarur të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit sipas një spektri më të gjerë kontrolli. Për më tepër që, ndërsa konkluzionet e arritura pas kontrollit të aftësive profesionale, në ndryshim nga ILD-ja, institucionet e rivlerësimit kalimtar, përveç se në kuadër të vlerësimit të kriterit profesional, munden potencialisht t’i trajtojnë dhe analizojnë në kuadër të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit, duke u dhënë atyre një peshë të caktuar dhe autonome, krahas problematikave të tjera të evidentuara në proces, për të vlerësuar nëse subjektet e rivlerësimit, me sjelljet, veprimet dhe mosveprimet e tyre, kanë cenuar ose jo besimin e publikut te drejtësia. Kjo analizë është e pamundur të kryhet prej ILD-së, që kryen verifikime në një kuadër shterues ligjor e që lidhet me shkeljet disiplinore të magistratëve dhe jo detyrimisht me elemente që tregojnë mungesë të aftësive profesionale, të cilat në vetvete nuk

përfaqësojnë shkelje disiplinore, por që janë elemente që përcaktojnë qëndrimin e institucioneve të rivlerësimit për kriterin e aftësive profesionale.

19.23. Për sa më sipër, lidhur me sjelljen e subjektit në këtë procedim, trupi gjykues konstaton se, minimalisht, për shkak të mangësive të theksuara profesionale, por, me shumë gjasa, edhe për shkak të problemeve që lidhen me integritetin, janë shkaktuar dëme të rëndësishme të interesave të shtetit dhe individëve, pasi ajo ka lejuar disponimin nëpërmjet akteve të falsifikuara, veprimtari e mbetur e pandëshkuar penalisht, të një pasurie prej 390 dynmësh tokë dhe, për më tepër, të zotëruar prej individëve me rekorde të rënda kriminale, siç rezulton edhe nga burime të hapura³⁹. Për pasojë, konkluzioni i Komisionit, lidhur me këto shkelje, konsiderohet i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe subjekti rezulton se me këtë rast ka cenuar nënindikatorët e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

19.24. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me procedimin penal nr. {***}/2012, në ngarkim të shtetasit F. Z., i hetuar për vrasjen e shtetasit A. D., me të cilat kundërshton konkluzionet e Komisionit, duke i konsideruar ato si *jo të drejta, pasi për këtë çështje penale, me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. {***}, datë 31.07.2014, ndaj saj është dhënë masë disiplinore “vërejtje” dhe se, për të njëjtën shkelje, nuk mund të ndëshkohet sërish, duke konstatuar dhe analizuar sa vijon.*

19.25. Në vendimin e Komisionit, lidhur me procedimin penal nr. {***}/2012, është analizuar dhe konkluduar se: *Nga shqyrtimi i vendimit nr. {***}, datë 30.4.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton se në datën 26.9.2012, shtetasi F. Z., së bashku me babain e tij, kanë shkuar për të prerë dru në vendin e quajtur {***}. Rreth orës 13:00, pasi kanë prerë drutë, në momentin që janë nisur për të shkuar në banesë, janë takuar me shtetasin A. D. Mes tyre ka filluar debati në lidhje me pronësinë e tokës dhe, në debat e sipër, shtetasi F. Z. ka nxjerrë nga brezi një armë zjarri pistoletë dhe ka qëlluar disa herë në drejtim të shtetasit A. D., duke e plagosur rëndë. Shtetasi A. D. është transportuar në spital dhe, më pas, ditën e nesërme, ka vdekur në Spitalin Ushtarak Tiranë. Nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor, i datës 4.12.2012, ka rezultuar se në trupin e viktimës, konstatohen plagë me armë zjarri tejshpuese dhe depërtuese, këto dëmtime janë shkaktuar nga predhat armë zjarri, jo nga një qitje e vetme. Drejtimi i qitjes është nga përpara-mbrapa dhe nga e majta në të djathtë, ndërsa distanca nuk mund të përcaktohet. Shkaku i vdekjes së shtetasit A. D., ka qenë shoku i rëndë traumatik-hemorragjik si pasojë e dëmtimeve të organeve të gjoksit dhe barkut.*

*Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për gjykimin e procedimit penal, duke e akuzuar të pandehurin për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 88/2 dhe 278/2 të Kodit Penal. Gjatë gjykimit, gjykata ka pranuar kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar. Në përfundim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 30.4.2013, ka pranuar kërkesën e prokurorisë dhe ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit për veprat penale të cituara më sipër dhe, pasi i ka zbritur 1/3 e dënimit, e ka dënuar përfundimisht me 7 vite burgim.*

Mbi bazën e ankimit të shtetasit N. D., Prokuroria e Përgjithshme ka filluar procedimin disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit. Në përmbajtjen e urdhrit për dhënien e masës disiplinore, pasqyrohet se kualifikimi ligjor i veprës penale në plagosje të rëndë, me pasojë vdekjen në ngarkim të autorit, është në kundërshtim flagrant me të dhënat që dalin nga aktet e fashikullit dhe dispozitat e Kodit Penal. Plagët e shumta me armë zjarri që i janë shkaktuar viktimës, shumica e tyre në organe jetike,

³⁹ Shih: <https://rtsh.al/spak-sekuestron-390-mije-meter-toke-te-biznesmenit-p-gj/>

si: në gjoks, bark dhe shpinë, tregojnë se qëllimi i vetëm i autorit, ka qenë vdekja e viktimës. Nga ana objektive, autori i ka kryer të gjitha veprimet, të cilat kanë sjellë si pasojë vdekjen e shtetasit A. D. Pavarësisht vdekjes jo të menjëhershme të viktimës, por pas disa orësh, për shkak të shokut të rëndë traumatik-hemorragjik nga plagët e shkaktuara me armë zjarri, është më se e qartë se ndodhemi para veprës penale të vrasjes.

Në vijim, pasqyrohet se prokurorja, në përfaqësimin e çështjes në gjykatë nuk ka mbajtur qëndrimin e duhur ligjor në lidhje me kërkesën për masë dënimi për veprën penale “Armëmbajtja pa leje”, pasi ka injoruar rrethanat e kryerjes së veprës penale, ku autori e ka përdorur armën dhe ka kërkuar një dënim prej pak më shumë se 1/4-ta e maksimumit të dënimit, që parashikonte dispozita e kohës. Gjithashtu, pasqyrohet se prokurorja nuk ka zbatuar me korrektësi nenin 55 të Kodit Penal mbi bashkimin e dënimeve, pasi rrethanat në të cilat janë realizuar të dyja veprat penale nga autori, si “Plagosja e rëndë me pasojë vdekjen” (sipas akuzës të ngritur nga prokurorja), ashtu edhe “Armëmbajtja pa leje”, që tregojnë një rrezikshmëri të lartë të autorit, çka impononte që prokurorja duhet t’i ishte referuar paragrafit të dytë të dispozitës së kohës për aplikimin e dënimit më të rëndë të shtuar.

Në përfundim, duke marrë në konsideratë karrierën e gjatë të prokurores, faktin se nuk është ndëshkuar asnjëherë me masë disiplinore, si dhe faktin që gjykata e ka gjetur të drejtë kualifikimin ligjor të prokurores, për veprën penale objekt gjykimi, Këshilli i Prokurorisë, me shumicë votash, ka sugjeruar të merret masa disiplinore “vërejtje”. Më pas, Prokurori i Përgjithshëm, duke marrë në konsideratë karakterin e shkeljeve dhe mendimin e Këshillit, me urdhrin nr. {***}, datë 31.7.2014, ka urdhëruar që prokurores Françeskina Lekani t’i jepet masa disiplinore “vërejtje”.

19.26. Subjekti i rivlerësimit, ndërsa ka pretenduar se kjo çështje është “gjë e gjykuar, për të cilën ka marrë një masë administrative”, ka potencuar se përfshirja e saj në vendim, në kushtet kur Komisioni nuk ka mbajtur një qëndrim për të, është bërë vetëm për të treguar që ajo është ndëshkuar me masën “vërejtje” nga Prokurori i Përgjithshëm.

19.27. Trupi gjykues, në analizë të sa më sipër, konstaton se Komisioni, marrjen e masës disiplinore “vërejtje”, pasi është konsideruar i gabuar cilësimi ligjor i faktit penal për të cilin ajo ka ngritur akuzë ndaj shtetasit F. Z., e ka konsideruar si një element të analizuar në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm që e ka çuar në konkluzionin për cenimin e besimit të publikut, por nuk i ka dhënë peshë kësaj çështjeje në funksion të vlerësimit të aftësive profesionale nëpërmjet potencimit të problematikave të konstatuara në procedimin disiplinor të kryer në vitin 2015.

19.28. Në vlerësimin e trupit gjykues, problematikat që kanë rezultuar nga verifikimi që Prokuroria e Përgjithshme i ka bërë këtij procedimi, të cilat nuk janë kontestuar në ankim nga subjekti, ndonëse nuk konsiderohen si elemente për të cilat subjekti do të thirrej në përgjegjësi në këtë proces, si shkaqe autonome, shërbejnë për të plotësuar situatën faktike që lidhet me aftësitë profesionale të subjektit, në funksion të një konkluzioni lidhur më këtë kriter. Dhënia e masës disiplinore prej Prokurorit të Përgjithshëm në vitin 2014, për një çështje që vlerësohet të jetë sensitive dhe që ka trajtuar ngjarje të rënda penale, me mangësi domethënëse prej subjektit, tregon për trupin gjykues, se aftësitë profesionale të subjektit janë konstatuar me mangësi edhe më parë, duke përforcuar bindjen se çështjet, të cilat janë analizuar rishtas prej Komisionit, nuk janë rastësore, por vijuese dhe me pasoja të rëndësishme në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve. Fakti që subjekti, për mangësitë e shfaqura në trajtimin e procedimit penal nr. {***}/2012, ka marrë masën disiplinore “vërejtje” nga Prokurori i Përgjithshëm, nuk përjashton analizimin e këtij procedimi nga një këndvështrim historik

i sjelljes profesionale të subjektit, në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar, i cili, mbi të gjitha, është një proces që ka për qëllim të evidentojë nëse subjektet e rivlerësimit, në funksion të konfirmimit në detyrë, arrijnë ose jo nivel minimal kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, nën dritën edhe të arsytimit pajtues të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese⁴⁰.

19.29. Lidhur me procedimin penal nr. {***}/2022, i cili lidhet me hetimin penal të ushtruar ndaj shtetasit Sh. D., për kryerjen e veprës penale të “Pengimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor”, parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal, trupi gjykues, krahas trajtimit që i bëri kësaj çështjeje, në kuadër të kriterit të vlerësimit të pasurisë, si më sipër arsyetuar, e risjell atë në vëmendje edhe në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit. Komisioni e ka konsideruar këtë situatë si një element që afekton vlerësimin e tij se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke potencuar ushtrimin e funksioneve në kushtet e papajtueshmërisë, si në cenim të parimit të paanësisë.

19.30. Trupi gjykues vlerëson se kjo sjelle profesionale e subjektit, nëpërmjet mosheqjes dorë nga ky procedim penal, në kushtet kur me të hetuarin ndodhej në kushtet e një marrëdhënieje debitore, në konsideratë edhe të natyrës së çështjes së hetuar, e cila kishte si objekt hetimi veprimet e të dyshuarit Sh. D., për mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor që e ngarkonte atë me detyrimin për kthimin e një shume prej 300.000 eurosh, dhe vetë vendimit të subjektit për të pushuar procedimin penal në fjalë, përveçse e vendos subjektin në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, gjithashtu e vendos atë edhe në kushtet e cenimit të indikatorit të paanësisë, parashikuar nga neni 75, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

20. Për sa më lart, trupi gjykues, pasi analizoi çështjet e trajtuara prej Komisionit në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, çmoi të drejta qëndrimet e mbajtura për sa u përket problematikave të konstatuara në procedimin penal nr. {***}/2020 të trajtuar prej subjektit, si dhe mbajti në konsideratë edhe situatën lidhur me procedimin penal nr. {***}/2012, për të cilin subjekti është ndëshkuar disiplinarisht, me masën “vërejtje”, të dhënë nga Prokurori i Përgjithshëm në vitin 2014, si edhe qëndrimet lidhur me procedimet e tjera penale të analizuara më lart, krahas situatës së ndodhjes në kushtet e cenimit të parimit të paanësisë.

20.1. Trupi gjykues – ndryshe nga Komisioni, duke potencuar veçanërisht shkeljet e konstatuara në procedimin penal me nr. {***}/2020, me pasoja të rënda për interesat ekonomike publike, skemën e përdorur nga individë me rekorde kriminale sipas burimeve të hapura publike, të cilët duket se kanë shfrytëzuar hallkat e dobëta të sistemit të drejtësisë për të arritur përfitimet e tyre materiale, si edhe situatën e mëparshme të trajtuar disiplinarisht, pa analizuar/vlerësuar atë, në të cilën subjekti sërish është shfaqur me defekte të spikatura në një procedim penal që lidhet me pasoja në drejtim jetës së individëve, duke demonstruar në këtë mënyrë, të paktën, mungesë profesionalizimi, por, me gjasa, edhe integriteti në trajtimin e çështjeve sensitive, si edhe cenimin e parimit të paanësisë në procedimin penal nr. {***}/2022, faktin që mangësitë profesionale janë shfaqur në mënyrë domethënëse edhe në

⁴⁰ Në këtë vendim, ndër të tjera, arsyetohet se:

“54. Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias) [...]”.

procedimin penal nr. {***}/2012 – vlerëson se mungesa e njohurive ligjore shfaqet e tillë në kuadër të nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, që për ligj kualifikimin e subjektit të rivlerësimit si “i papërshtatshëm”, sipas parashikimit të nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

21. Për pasojë, në ndryshim nga Komisioni që e ka kualifikuar këtë situatë sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, në bazë të së drejtës së parashikuar nga neni 16 i Kodit të Procedurës Civile dhe në garantim të parimit *no refeformatio in peius*, meqenëse subjekti është mbrojtur për të gjitha shkeljet dhe pasoja e ardhur nuk ndryshon/rëndohet, vlerësoi të ndryshojë këtë kualifikim ligjor të bërë prej Komisionit, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
22. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit objekt gjykimi, trupi gjykues, në vlerësim dhe analizë të qëndrimeve të mësipërme, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk përmbush kriteret kushtetuese për arritjen e një niveli të besueshëm në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, sipas kërkesave të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe se problematikat e konstatuara në shqyrtimin e disa procedimeve penale, janë situata të cilat e bëjnë subjektin të papërshtatshëm për të vijuar detyrën, në kuptim të nenit E, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Konkluzionet e mësipërme e vendosin subjektin në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si dhe të kualifikimit si “e papërshtatshme”, për sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 61 pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se vendimi nr. 721, datë 06.12.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur shkarkimin e saj nga detyra, është marrë mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 721, datë 06.12.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Françeskina Lekani.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 19.05.2025.

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi